

**Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!**

# Bashkimi

ORGAN I KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË E RIORGANIZUAR

Nr. 23

E Shtunë 21 mars 2009

Çmimi 30 lekë

## PUNË, MIRËQENIE, SIGURI PËR TË GJITHË

Fjala e Sekretarit të Parë të KQ të PPSHR, shokut Marko Dajti, mbajtur në Aktivin e Partisë



### Shokë dhe shoqe!

Po mbushen dy vjet nga riorganizimi i Partisë sonë dhe sot është një ditë e shënuar për të gjithë ne anëtarët dhe simpatizantët e PPSHr që marrin pjesë në këtë aktiv, ku do të shpalojmë alternativat tona në shërbim të popullit e vendit tonë të mrekullueshëm.

Vendi ynë drejtohet nga një qeveri e paaftë, e korruptuar deri në palcë, e cila me sloganin "Të luftojmë korrupsionin" erdhi në pushtet. Populli votoi me shpresën e një të ardhme më të mirë, por e vërteta flet ndryshe. Jeta e popullit të

thjeshtë sot nuk mund të krahasohet me atë të viteve kur në pushtet ishte Partia e Punës dhe shoku Enver.

Atëherë kujdesej Partia për punësimin e rinisë, sapo mbaronte shkollën e mesme apo të lartë, kurse sot rinia ka mbetur në mes të rrugës, e pushtuar nga dëshpërimi, stresi, duke mos pasur jetë të sigurt nga droga, sida, prostitucioni, gjë e cila i ka detyruar të marrin rrugën e kurbetit, të shpërndarë në të gjithë botën, ku kanë gjetur edhe vdekjen, janë mbytur nëpër detra me gomone, janë të nëpërkëmbur nga të huajt, duke ulur dinjitetin e tyre.

Po afron viti që ndodhi një nga tragjeditë më të

mëdha të këtij vendi, ajo e Gërdecit dhe qeveria e Sali Berishës nuk ka gjetur akoma fajtorët. Kjo qeveri nuk ka si t'i gjejë ata, sepse ajo është vetë e ngatërruar në këtë histori, ku korrupsioni u ka zënë sytë dhe nuk shohin të vërtetën.

Ra pallati 5 katësh në Gjirokastër, mbetën nën rrënoja nënë e bijë, mbetën të pastrehë banorët e tij, askush nuk mendon për ta.

Askush nuk mendon seç bëhet me tregun, ku kanë vajtur çmimet, të cilat rriten çdo ditë, ku janë premtimet se do të kemi ujë dhe drita 24 orë? Ndërkohë që para viteve '90 për një problem të

lexoni në faqen 3 →

### REFLEKSION

#### LETËR

Drejtuar Presidentit të Republikës z. Bamir Topi

E ndjejmë si obligim tonin T'Ju drejtohem i Juve, si Kreu i Shtetit dhe Personaliteti i parë i vendit, lidhur me disa qëndrime dhe dukuri thellësisht anti-kombëtare, që kohët e fundit janë shfaqur në jetën e vendit, të cilat synojnë të falsifikojnë historinë dhe të godasin figurat e shquara historike kombëtare...

lexoni në faqen 2 →

### ANALIZË

#### Berisha njeriu i serbëve

NGA HETEM HALILI

Është koha që ta themi troç dhe me zë të lartë: Berisha, përveçse është në krye të kupolës mafioze në pushtet, njëherazi është edhe njeriu i serbëve dhe në shërbim të tyre. Ka gati 20 vjet që, në sjelljen e tij duket qartë se ka një mision...


lexoni në faqen 4 →

#### Në parlament për Shqipërinë dhe popullin


NGA MUHO ASLLANI

Në marrjen e vendimit për t'u futur në fushatën e zgjedhjeve na ka udhëhequr sa besimi ynë për t'i shërbyer deri në fund popullit dhe atdheut, aq edhe ndërgjegjës...

lexoni në faqen 3 →



# Në sallën e Muzeut Kombëtar zhvillohet AKTIVI I PPSHR



Më datën 23 janar 2009, në sallën e Muzeut Kombëtar, në orën 10.00 u zhvillua Aktivi i PPSHR mbi pjesëmarrjen në zgjedhjet parlamentare. Pas tingujve emocionues të Himnit Kombëtar, fjalën e hapjes e mori shoku Muho Asllani, i cili përshëndeti pjesëmarrësit në këtë eveniment dhe bëri të ditur programin e zhvillimit të këtij Aktivi.

Raporti kryesor u mbajt nga shoku Marko Dajti, Sekretar i Parë i Komitetit Qëndror të PPSHR, i cili u shpreh se "në këtë aktiv do të shpalosim alternativat tona në shërbim të popullit e vendit tonë të mrekullueshëm".

Në fillim, ai bëri një pasqyrë të gjendjes aktuale të vendit nën drejtimin e një qeverie tejet të korruptuar dhe të paaftë, e cila me sloganin "Të luftojmë korrupsionin" erdhi në pushtet dhe populli votoi me shpresën e një të ardhmeje më të mirë. Por e vërteta flet ndryshe. Jeta e popullit të thjeshtë sot nuk mund të krahasohet me atë të viteve kur në pushtet ishte Partia e Punës dhe shoku Enver.

Me pas, ai bëri një rezume e punës dhe veprimtarisë së organizatave të Partisë në qendër dhe në rrethe, që nga koha e krijimit e deri në ditët e sotme, ku midis të tjerash veçoi punën e mrekullueshme dhe shembullore të bërë nga organizata bazë e Partisë në Korçë nën drejtimin e Sekretarit të kësaj organizate shokun Gjerak Larti, i cili ka sponsorizuar edhe pjesën më të madhe të veprimtarive të zhvilluara në këtë rreth. Gjithashtu u vlerësua si shembull për të gjitha organizatat e tjera puna e organizatës së gruas në këtë rreth nën drejtimin e kryetares së palodhur Olga Gora, duke sjellë shtimin e radhëve të kësaj organizate me gra dhe të reja.

## PPSHR-DORË E NGROHTË DHE E SIGURT



Pamje nga punimet e Aktivit të PPSHR

"S'mund të lë pa përmendur dhe përshëndetur organizatat e Partisë në rrethin e Beratit që u kthyen tek Partia jonë dhe i falenderoj nga zemra shokët Astrit Rusi, Aleko Boçi, Zoi Gjoni për mbështetjen që na dhanë", theksoi midis të tjerash shoku Marko Dajti. Dua të vlerësoj gjithashtu punën e palodhur, pavarësisht kushteve të vështira të ndikuara nga sistemi i sotëm qeverisës, të bërë në rrethet Fier, me sekretar shokun Pasho Zhupa, Sarandë me shokun Pandeli Lulo, Vlorë me shokun Thoma Greveni, Durrës me shoqen Vera Bajraktari, Ersekë, Kukës, Mirditë, Gjirokastrë, Përmet, etj. Duhet të na gëzojë sadopak edhe fakti që gjatë kësaj kohe janë ngritur organizatat e rinisë në rrethet Korçë, Elbasan, Vlorë, Tiranë etj, sepse kjo rini është e ardhmja jonë dhe është ajo që do

të sjellë tek ne frymën e re bashkëkohore. Le të ngrejme zërin tonë së bashku me zërin e fëmijëve tanë, vëllezërve tanë kudo që janë në mbrojtje të të drejtave tona, në mbrojtje të vetes dhe të të ardhmes më të mirë, ku të dominojë mirëqenia, dashuria, mirëkuptimi, respekti, e vërteta, buzëqeshja, të cilën duam t'ua kthejmë shqiptarëve.

Në mbyllje të fjalës së tij ai u shpreh: "Ne duhet të bashkohemi fort rreth Partisë sonë dhe me programin tonë elektoral t'i tregojmë gjithë popullit se cila është alternativa e vërtetë, cila Parti është afër tyre dhe halleve të tyre, e cila shpaloset më së miri në sloganin tonë: "Bashkohuni me ne: Punë, mirëqenie, siguri për të gjithë".

Më pas diskutuan shokët Pasho Zhupa në emër të organizatës së

Fierit, i cili vuri theksin tek puna e madhe që na del përpara për të realizuar fitoren në zgjedhje.

Shoqja Olga Gora përshëndeti në emër të organizatës së gruas, duke i dhënë rëndësi të madhe rolit të gruas në veprimtarinë e partisë, si një forcë e madhe mbështetëse në objektivat për të ardhmen. Odise Hyso, në emër të organizatës së rinisë falenderoi për ndihmën e madhe që i kanë dhënë kësaj organizate anëtarët dhe simpatizantët në shtimin e radhëve të tyre, sepse rinia e ndjen veten të pasigurt në këtë qeveri që nuk i hap asnjë perspektivë për të ardhmen. Prandaj, theksoi ai "ne gjejmë një dorë të ngrohtë dhe të sigurt tek PPSHR dhe jemi të bindur se kjo dorë do të jetë udhërrëfyese në rrugën e gjatë dhe të vështirë që na pret përpara".

Gjet Lleshi në emër të organizatës së Mirditës, nxorri në pah vështirësitë e shumta që kanë ndeshur në punën e tyre në këtë rreth, për shkak të kundërshtive partiake që ekzistojnë si kudo në vendin tonë. Por, theksoi ai, ne nuk do të tërhiqemi sepse nuk ka asgjë që nuk arrihet me punë dhe përpjekje. Do të realizojmë qëllimin tonë, shtimin e radhëve me anëtarë të rinj.

Në diskutimet dhe debatet që u zhvilluan midis pjesëmarrësve u shkëmbyen ide dhe mendime për të ndërtuar edhe më mirë punën e partisë sonë, për t'u prezantuar me bindje të plotë dhe me objektiva të sakta para popullit në zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009, në mënyrë që Partia jonë të përfaqësohet me 5 deputetë.

NGA BORANA VASO

## LETËR

Drejtuar Presidentit të Republikës Z. Bamir Topi

I nderuar zoti Zoti President!

E ndiejmë si obligim tonin T'Ju drejtohem i Juve, si Kreu i Shtetit dhe Personaliteti i parë i vendit, lidhur me disa qëndrime dhe dukuri thellësisht anti-kombëtare, që kohët e fundit janë shfaqur në jetën e vendit, të cilat synojnë të falsifikojnë historinë dhe të godasin figurat e shquara historike kombëtare; veçanërisht të mohojnë LANÇL, heronjtë dhe dëshmorët e kësaj lufte, të atyre që falën gjakun dhe dhanë jetën për çlirimin e vendit. LANÇL është një nga faqet më të lavdishme në tërë historinë e kombit tonë; partizanët dëshmorë, me aktin e tyre sublim kanë hyrë me nder e lavdi në altarin kombëtar dhe askush nuk ka tagrin dhe të drejtën të mohojë aktin e tyre, t'i denigrojnë, t'i përbuzë e të tallet me ta. Kush e bën këtë, mohon shenjtërinë e gjakut të derdhur për lirinë. Ata janë pjesë e historisë sonë të lavdishme, histori që nuk mund të ç'bëhet sipas dëshirës dhe orekseve të qarqeve anti-shqiptare brenda dhe jashtë vendit. Ata kanë qenë e do të jenë kurdoherë burim frymëzimi për brezat dhe meritojnë respektin dhe nderimin më të madh.

Në këto situata, ne përcollëm me shqetësimin dhe me dhimbjen më të thellë aktin absurd, të rëndë e të turpshëm të Këshillit Bashkiak të Shkodrës për heqjen e monumentit të pesë heronjve të Vigut: Ahmet Haxhisë, Ndoc Mazit, Naim Gjylbegut, Hydajet Lezhës dhe Ndoc Dedës, të cilët dhanë jetën në 21 gusht të 1944-ës në përpjekje

e të rrethuar nga një bandë kriminelësh, kolaboracionistë e bashkëpunëtorë të zellshëm të pushtuesve nazistë. Akti i dënueshëm i këshilltarëve të Bashkisë së Shkodrës i frymëzuar e realizuar në kuadrin e revanshit të forcave me prirje profashiste e anti-kombëtare të këtij këshilli, përbën një turp që nullohet dhe ul imazhin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve në mbarë botën. Përveç indignatës që ngjalli ky akt në radhët e veteranëve të lavdishëm, veçanërisht të atyre të LANÇL dhe në mbarë opinionin përparimtar shqiptar, indignatë të thellë ka ngjallur edhe në opinionin ndërkombëtar. Këtë e tregon bukur e qartë reagimi i menjëhershëm i organizatave përparimtare dhe antifashiste italiane dhe letrat e shumë partizanëve italianë që kanë luftuar në Shqipëri, partizanëve shqiptarë, të cilët, duke shfrytëzuar vizitën ardhshme të Presidentit Napolitano në Shqipëri i shkruajnë Atij: "I dashur President i Republikës Italiane. E dimë që në ditët e ardhshme do të jeni për vizitë në Shqipëri. Në këtë rast duam t'ju informojmë për aktin e rëndë të kryer në ditët e kaluara, në Shkodër, ku është zhvendosur Monumenti i Pesë Heronjve të Vigut, duke e spostuar nga qendra e qytetit në një zonë periferike përpara koshave të plehrave. Në shenjë vlerësimi e nderimi të këtyre dëshmorëve ata shkruajnë se libri i famshëm: "Letra nga të dënuarit e Rezistencës Evropiane", me mësimet e së cilës janë edukuar një gjeneratë e tërë, hapet pikërisht me letren e partizanëve shqiptarë, heronjtë e popullit: Ndoc Deda, Ndoc Mazi, Naim Gjylbegu, Hydajet Lezha dhe Ahmet Haxhia, rënë duke luftuar më 21 gusht 1945 kundër bandave, bashkëpunëtorë të nazistëve. Duke vazhduar më tej, ata citojnë letrën që dërgojnë pesë këta heronj ku shkruhet: "Të dashur shokë! Jemi të rrethuar dhe, nga një moment në tjetrin, presim të goditemi nga tradhtarët, por e kemi thënë njëherë e përgjithmonë: "O liri, o vdekje". Të tillë ishin heronjtë, monumenti i të cilëve u hodh në vendgrumbullimin e

plehrave.

Është tepër e dhimbshme kur luftën tonë e njohin dhe e vlerësojnë të huajt, kur për dëshmorët dhe heronjtë tanë kanë respekt e nderim të huajt, kur ata indinjohen e shqetësohen për aktin e përdhosjes së heronjve të Vigut, brenda vendit ka forca antishqiptare me prirje profashiste, të cilat mundohen ta mohojnë atë dhe përipiqen me të gjitha forcat dhe mundësitë të fallsifikojnë historinë të denigrojnë figurat e shquara kombëtare, heronjtë dhe dëshmorët e Atdheut, siç vepruan edhe një grusht këshilltarësh të papërgjegjshëm të Bashkisë së Shkodrës me Pesë Heronjtë e Vigut.

I nderuar Z. President!

Duke shprehur shqetësimin tonë të thellë për këto dukuri me prapavijë të theksuara antikombëtare, J'u drejtohem i Juve, duke pasur besimin e plotë e të patundur se, me autoritetin Tuaj dhe me kompetencat që Ju jep detyra Juaj e lartë, do të ndërhyni me forcën e duhur në favor të ndreqjes së kësaj situatë absurde që është krijuar, për t'u prerë rrugën njëherë e përgjithmonë akteve të tjera të goditjes së figurave historike, të denigrimit të heronjve e dëshmorëve, të poshtërimit të atyre që i sollën lirinë popullit e vendit dhe, do të jepni porositë e nevojshme për të vënë në vendin ku e meriton monumentin e Pesë Heronjve të Vigut, në qendër të Shkodrës, atje ku populli i Shkodrës e ka dashur dhe e ka parë për mbi pesëdhjetë e ca vjet.

Me respekt.

Komiteti Qëndror i PPSHR

Sekretari i Parë  
MARKO DAJTI

# Punë, mirëqenie, siguri për të gjithë

Fjala e Sekretarit të Parë të KQ të PPSHR, shokut Marko Dajti, mbajtur në Aktivin e Partisë

← vijon nga faqja 1

tillë as nuk mendohej, se popullit tonë nuk i mungonte as uji e as drita 24 orë.

Përmenda shumë pak nga hallet e mëdha të këtij populli të vuajtur, për t'i treguar se fatet e tyre janë grumbulluar në duart e disa njerëzve të djathtë e të majtë, të cilët në emër të këtij populli të mrekullueshëm, punëtor e arsimdashës, bëjnë be se po punojnë për mirëqenien e tij, kur në të vërtetë kanë rritur mirëqenien e tyre, të cilëve nuk iu numurohen vilat në bregdet, milionat dhe makinat luksoze.

Partitë e majta si LSI-ja e Ilir Metës, PS-ja e Edi Ramës e ndonjë parti tjetër e majtë grinden me njëra-tjetrën për pushtet, pa kthyer sytë nga elektorati që shpreson tek programi i tyre.

Kemi hyrë në vitin elektorale. Në qershor 2009 do të zhvillohen zgjedhjet për në Kuvendin e Shqipërisë. Ne duhet të bashkohemi fort rreth Partisë sonë dhe me programin tonë elektorale t'i tregojmë gjithë popullit se cila është alternativa e vërtetë, cila parti është afër tyre dhe halleve të tyre, e cila shpaloset më së miri në sloganin tonë: "Bashkohuni me ne: Punë, mirëqenie, siguri për të gjithë".

Mendoj se po të punojmë me urtësi e durim, kokë më kokë e shtëpi më shtëpi me njerëzit tanë për t'ua bërë të qartë pse ne po luftojmë. Nuk ka objektiv që nuk arrihet dhe ne do ta arrijmë, optimizmi dhe besimi nuk na mungon.

Le të ngrejmë zërin tonë së bashku me zërin e fëmijëve tanë,

vëllezërve tanë kudo që janë në mbrojtje të të drejtave tona, në mbrojtje të vetes dhe të të ardhmes më të mirë, ku të dominojë mirëqenia, dashuria, mirëkuptimi, respekti, e vërteta, buzëqeshja, të cilën duam t'ua kthejmë shqiptarëve, pasi ajo ka kohë që iu mungon, sepse pushtetarët e sotëm, pozita dhe opozita, u ka ngrirë buzëqeshjen.

Mjafton t'i bëjmë një analizë vitit 2008, vit në të cilin pati rreth 380 vetëvrasje, ose një shqiptar në ditë vret veten. Askush nuk vret veten për qejf, por nga hallet e problemet që i ka sjellë sistemi i sotëm. As që mund të mendohej se mund të ndodhnin dukuri të tilla gjatë 45 vjetëve të pushtetit popullor socialist nën udhëheqjen e Enver Hoxhës.

Gjatë këtyre dy vjetëve, Partia jonë është munduar të qëndrojë pranë popullit të thjeshtë dhe atyre që pranojnë programin tonë, duke zhvilluar takime të shumta si në Korçë, Vlorë, Shkodër, Durrës, Sarandë, Fier, Mirditë, Berat etj. Është momenti që të veçoj punën e mrekullueshme dhe shembullore të bërë nga organizata bazë e Partisë në Korçë nën drejtimin e Sekretarit të kësaj organizate shokun Gjerak Larti, i cili ka sponsorizuar edhe pjesën më të madhe të veprimtarive të zhvilluara në këtë rreth. Por jo më pak vlen të përmendet dhe mendoj se duhet të merret si shembull për të gjitha organizatat e tjera puna e organizatës së gruas në këtë rreth nën drejtimin e kryetares së palodhur Olga Gora, e cila edhe pse jo në gjendje të mirë shëndetësore ka qenë kurdoherë e gatshme, e papërtuar dhe ka njohur vetëm suksese, duke sjellë shtimin e radhëve të kësaj

organizate me gra dhe të reja. Gjithashtu kjo organizatë po merr përpjestime të gjera edhe në rrethet Fier, Durrës, Elbasan etj., pasi gruaja është gjysma e popullsisë dhe njëkohësisht mbështetja kryesore e Partisë për realizimin e zgjedhjeve të qershorit 2009.

Dua të vlerësoj gjithashtu punën e palodhur, pavarësisht kushteve të vështira të ndikuara nga sistemi i sotëm qeverisës, të bërë në rrethet Fier, me sekretar shokun Pasho Zhupa, Sarandë me shokun Pandeli Lulo, Vlorë me shokun Thoma Greveni, Durrës me shokun Vera Bajraktari, Ersekë, Kukës, Mirditë, Gjirokastrë, Përmet, etj. S'mund të lë pa përmendur dhe përshëndetur organizatat e Partisë në rrethin e Beratit që u kthyen tek Partia jonë dhe i falenderoj nga zemra shokët Astrit Rusi, Aleko Boçi, Zoi Gjoni për mbështetjen që na dhanë. Dua të përshëndes në veçanti nga zemra të palodhurin dhe komunistin më të ndershëm të Partisë sonë, aktualisht kryetar i Komisionit të Kontrollit të Revizionimit, shokun Kadri Kryekurti dhe po të punojmë të gjithë në shembullin e tij, partia jonë pa frikë, do të thosha se do të kishte arritje më të mëdha.

Por jo vetëm kaq, duhet të na gëzojë sado pak edhe fakti që gjatë kësaj kohe janë ngritur organizatat e rinisë në rrethet Korçë, Elbasan, Vlorë, Tiranë etj, sepse kjo rini është e ardhmja jonë dhe është ajo që do të sjellë tek ne frymën e re bashkëkohore. Po theksoj këtu rëndësinë e veçantë të takimit që një grup të rinjsh të Partisë zhvilluan në kryeqytetin helen të Greqisë, Athinë në datat 11-13 korrik 2008, organizuar nga KOE (Organizata Komuniste e Greqisë)

dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Greqisë me moton "Rezistencë 2008". Për të rinjtë tanë kjo ishte dhe mbeti një eksperiencë e mrekullueshme, ku mësuan, morën dhe dhuruan shumë ide për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve midis miqve tanë të rinj. Mbi të gjitha, viti 2008 për ne komunistët ishte viti i 100-vjetorit të lindjes së udhëheqësit legjendar të partisë dhe të popullit, shokut Enver Hoxha, që ne e festuam me madhësi bashkë me familjen e Enver Hoxhës në Gjirokastrë këtë ngjarje historike.

Nuk mund të lë pa përmendur punën e bërë nga anëtarët e partisë sonë me njerëzit e lëkundur, kohë pas kohe e shtëpi më shtëpi, qoftë edhe me takime konfidenciale, gjë që na ka dhënë rezultat në shtimin e numrit të anëtarëve tanë, pasi ky është edhe synimi kryesor i partisë sonë. Megjithatë mendoj se puna jonë në këtë drejtim duhet të ishte më e madhe, duke filluar nga familja jonë, të afërmit tanë, shoqëria jonë, vendi ku ne punojmë dhe jetojmë.

Në këtë këndvështrim është detyrë e anëtarëve dhe e simpatizantëve të PPSHR që të punojnë parreshtur me masat e popullit për t'ua hapur sytë atyre që të shohin dhe të kuptojnë lojën që po luhet në kurriz të tyre, me qëllim që ato të gjejnë rrugën e vërtetë të shpëtimit që është mbështetja ndaj PPSHR, ndaj socializmit dhe mësimeve të Enver Hoxhës.

Pikërisht, përsa u tha më sipër, ne e shikojmë pjesëmarrjen e PPSHR si konkurruese në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2009, si një domosdoshmëri, si një detyrim ndaj masave të shtypura e të varfëra të popullit tonë. Duke patur përfaqësuesit e Partisë sonë në Parlament do të bëhet e mundur një opozitë konstruktive e cila do të shpalosi para popullit idetë dhe programin politiko-ekonomik e social të PPSHR. Kjo do të na japë shanset dhe mundësinë për rritjen numerike të Partisë dhe të forcës së saj në të ardhmen.

Dy partitë e mëdha PD dhe PS, kanë formuluar e miratuar një Kod

kujtesën e njerëzve si një parti fashiste, synimi i saj është shkatërrimi i gjithçkaje të ndërtuar në vitet e pushtetit popullor. Faktori kryesor për plotësimin e objektivave që kemi në këto zgjedhje, është puna jonë, roli dhe përkushtimi i të gjithë anëtarëve dhe simpatizantëve të Partisë sonë, aty ku jetojmë e veprojmë. Këto ditë, së bashku me Sekretarin e Parë të KQ të PPSHR, shokun Marko Dajti, kemi zhvilluar disa takime me shokë dhe grupe të ndryshme ilegalesh, që nuk kanë qenë anëtarë, por edhe ish anëtarë të Partisë Socialiste, Demokratike dhe partive të tjera, të cilët të zhgënjyer nga premtimet boshe dhe korrupsioni i madh i liderëve të tyre, janë shkëputur, janë zotuar, na kanë dhënë besën e patriotit, se votën do ta hedhin për PPSHR, sepse vota është e shenjtë. Shumë njerëz, që deri tani kanë qëndruar indiferentë, por që kanë qenë dhe janë trima, të zgjuar, të vendosur, që karakterizohen nga drejtësia dhe zbatimi i ligjit për të gjithë njëllë, na kanë premtuar se do të na e japin votën jo vetëm familjarisht, por së bashku me shokët dhe miqtë e tyre. Veç kësaj premtojnë se do ta ruajnë votën, të mos e vjedhin ata që e kanë

→ vijon në faqjen 5

Zgjedhor për interesat e tyre, me qëllimin e vetëm për të monopolizuar kontrollin mbi votat e popullit e manipulimin e tyre, si dhe për të penguar pjesëmarrjen e partive të vogla në zgjedhje. Barriera kryesore që ata i vunë në ligjin zgjedhor është depozitimi në KQZ të 10 mijë firmave të noterizuara për t'u regjistruar si subjekt politik. Sigurisht 10 mijë firma janë shumë, por detyra jonë është që me punën tonë t'i sigurojmë ato dhe t'u përfaqësojmë juve me dinjitet në Parlamentin shqiptar. Deputetët tanë do të jenë syri dhe veshi juaj, të cilët me fjalën e tyre do të mbrojnë të drejtat tuaja, familjet tuaja, fëmijët tuaj, prandaj thirrja jonë është që: votën tuaj mos e humbni kot, por hidheni aty ku e ndjeni veten të mbrojtur dhe të sigurt për të lumturuar jetën tuaj.

Jemi ne dhe të gjithë anëtarët e Partisë dhe simpatizantët që duhet ta realizojmë këtë kusht, duke filluar nga puna qysh nesër.

Kushti i dytë është se sipas Kodit Zgjedhor, 30% e kandidatëve për deputet duhet të jenë femra. Edhe këtë detyrim ligjor kemi besim se do ta kapërcejmë. Edhe në këtë drejtim, për përzgjedhjen e kandidatëve të denjë e me reputacion, puna duhet të fillojë menjëherë nga të gjithë strukturat e Partisë në bazë e deri në qendër.

Përballimi i fushatës elektorale kërkon edhe vlera financiare. Ligjet e pushtetit borgjez nuk i japin asnjë lekë PPSHR, meqenëse nuk kemi deputet në Parlament, prandaj duhet të mbështetemi vetëm në forcat tona. Në këtë aspekt, të gjithë duhet të punojmë e sakrifikojmë për të siguruar mjetet financiare të domosdoshme nëpërmjet mbledhjes së kontributeve, sipas mundësive, nga anëtarët e Partisë, nga simpatizantët e biznesmenët që na mbështesin, të realizojmë mbledhjen e kuotave të anëtarësisë sipas Statutit si dhe gazeta e Partisë të shitet në masën 85-90%.

Shokë dhe shoqe!

Detyrat që kemi në kuadër të kësaj fushate janë të shumta dhe aspak të lehta, por jo të paarrishme. Por që t'i realizojmë ato kërkohet nga të gjithë ne përkushtim, mobilizim dhe punë e palodhur e me ndjenjë të lartë përgjegjësie, besim në vetvete e në fitore. Për komunistët nuk ka kala që të mos merret. Ne nuk kërkojmë lëmshë nga borgjezia, çka nuk do të na e jepte kurrë, por fitoren duhet ta mbështesim vetëm në punën, sakrificat dhe në forcat tona, ashtu siç na ka mësuar praktika gjysmë shekullore heroike e revolucionare e mësuesit tonë të lavdishëm, shokut Enver Hoxha.

Duke përfunduar, në emër të Byrosë së Komitetit Qendror të Partisë, ju bëj thirrje të vendosim pjesëmarrjen në zgjedhjet Parlamentare të qershorit 2009, të miratojmë Vendimin e Programin përkatës, të hapim fushatën tonë elektorale me aktivin e ditës së sotme dhe qysh nga dita e nesërme të shpallim aksionin e madh politik, organizativ e propagandistik të fushatës elektorale.

Objektivi ynë është që të përfaqësohemi në Parlamentin e ardhshëm me 5 deputetë. Gjithashtu, ju uroj juve dhe të gjithë anëtarëve e simpatizantëve të Partisë sonë:

Punë të mbarë, suksese dhe fitore në zgjedhjet Parlamentare!



Shoku Muho Asllani

## Në parlament për Shqipërinë dhe popullin

e majtë në spektrin e politikës shqiptare, janë disa nga faktorët që veprojnë në favorin tonë. Situata aktuale karakterizohet nga një krizë e thellë politike, ekonomike, morale e nga çdo pikëpamje, si rezultat i një qeverisjeje të keqe, i keqvendosjes së pushtetit ligjor, pra ligji të jetë njësoj për të gjithë. Ka plasur sherri i ashpër midis partive të djathta dhe atyre të ashtuquajtura të majta. Në Shqipëri, sot janë ulur këmbëkryq krimi, korrupsioni, papunësia dhe varfëria, grindjet dhe mosmarrëveshjet, lufta për pushtet, se kush t'ia hajë kokën shokut të vet. Qeveritarët tanë, kryesisht kryeministri Sali Berisha, çirren nëpër mbledhje, takime, tribuna e mitingje për sukseset e qeverisë berishiane. Ata, në vend që të zgjidhin problemet jetike që kanë sot shqiptarët, për punë, për ushqim, për drita, për ujë etj., merren me probleme anësore, me probleme të interesit personal e të familjeve të tyre, për t'ua pasuruar sa më shumë

në kurriz të popullit fukara.

Partia jonë është tashmë një forcë vitale, serioze dhe e organizuar mirë, ç'ka përbën edhe bazën e shëndoshë për të ecur përpara në zbatim të Programit dhe të Statutit të saj. Është momenti që, në këto zgjedhje të shpaloset edhe njëherë programi i Partisë sonë në masat e popullit, dhe nga rezultatet që do të arrijmë njerëzit do të kuptojnë se kush është vërtetë Partia marksist-leniniste, që na la trashëgim dhe amanet i pavdekshmi Enver Hoxha.

Problemin e zgjedhjeve për në Parlamentin e ardhshëm nuk e shtrojmë për herë të parë. Sinjalin për një punë përgatitore për këtë fushatë shumë të rëndësishme, e kemi dhënë gjatë gjithë vitit 2008, kur përgatiteshim dhe festuam me dinjitet 100 vjetorin e ditëlindjes së mësuesit tonë të paharruar Enver Hoxha. Koha dhe situatat punojnë në favorin tonë, prandaj duhen shfrytëzuar. Partia Demokratike e Sali Berishës tashmë ka hyrë në

Komiteti Qëndror i PPSHR vendosi të marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, më datën 28 qershor 2009. Në marrjen e vendimit për t'u futur në fushatën e zgjedhjeve na ka udhëhequr sa besimi ynë për t'i shërbyer deri në fund popullit dhe atdheut, aq edhe ndërgjegjësimi se qenia në Parlament i krijon Partisë sonë kushte të favorshme pune e zhvillimi më të shpejtë. Përvoja e fituar në fushatat e mëparshme elektorale dhe forcimi i strukturave tona organizative, zhgënjimi masiv i elektoratit dhe mbështetja në rritje e PPSHR, si e vetmja forca e vërtetë

# Vizitë e suksesshme në Itali

- Reportazh nga vizita e Sekretarit të Parë të PPSHR, shoku Marko Dajti në Itali -

**"Një delegacion autoritar i PPSHR është mysafir në selinë e Partisë Komuniste Italiane në Ischia për bisedime midis dy partive motra marksiste-leniniste".**

Në këtë mënyrë u bë e njohur nga gazeta lokale e Napolit "Il Golfo" vizita e delegacionit të PPSHR në Ischia të Italisë, i kryesuar nga shoku Marko Dajti, me ftesë të Komitetit Qëndror të PKM-L të Italisë nën drejtimin e shokut Domenico Savio. Një pritje shumë e ngrohtë dhe e përzemërtiu rezervua që në momentin e zbritjes nga trageti, ku kishin dalë për të pritë delegacionin tonë Kryetari i Partisë Komuniste të Italisë, shoku Domenico Savio, shumë shokë të tjerë anëtarë të udhëheqjes, të cilët mbanin në duar flamujt me simbolin e kësaj partie dhe të marksizëm-leninizmit. Një pritje e paparashikuar, e cila bëri që delegacionin ynë të ndihej si mes miqsh të vjetër. Ndoshta bindjet dhe kauza e përbashkët që i lidh të dyja partitë krijojnë një afektivitet të tillë në këtë takim. Që në momentet e para delegacionin ynë u ndje shumë komod në atmosferën e krijuar nga mikpritja e miqve tanë në ambjentet e selisë së PKI, e veçanta e së cilës ishte ngjyra e kuqe dhe e verdhë me të cilën ishte dizenuar godina si nga jashtë, po ashtu edhe nga brenda me të njëjtin motiv-simbol. Në hyrje të uronin mirëseardhjen katër foto të mëdha të klasikëve të mëdhenj Marksit, Engelsit, Lenini dhe Stalini, si edhe flamuri me simbolin drapër e çekan që nderonte të gjithë ata që vizitonin këtë seli. Menjëherë të binte në sy biblioteka e stërmadhe me morinë e librave që ngjasonte me një arkiv të tërë ku shpalosej një horizont i pafund dijes, historish që mbanin brenda vetes misteret e të gjitha kohërave. Me finesë dhe rregull, që vetëm një nikoqire e mirë mund t'i kishte mbrojtur dhe sistemuar në atë mënyrë ishin rreshtuar shumë, për të mos thënë të gjitha veprat e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit, gjë që dëshmonte më së miri nostalgjinë dhe besnikërinë e patundur të kësaj partie në mësimet e klasikëve të marksizëm-leninizmit. Duke na treguar për këtë bibliotekë, në një moment shoku Domenico Savio shprehet "Ne themi që çdo komunist ka një Marks të ri, një manifest të ri me një forcë të re dhe kur flasim për marksizëm-leninizmin nuk flasim për gjëra abstrakte". Një thënie që po të analizohet ka shumë për të treguar dhe për të konkluduar për të ardhmen.

Pas vizitës në ambjentet e kësaj selie, mes miqve të shumtë takimi u zhvillua në një atmosferë tepër të ngrohtë. Shoku Marko Dajti bëri një rezumë të historisë së PPSHR, si pasuese e denjë e Partisë së Punës e Shqipërisë e cila e nisi aktivitetin e saj në 22 nëntor 1948 dhe, ishte shoku Enver Hoxha njeriu politik dhe revolucionar që dënoi me vdekje okupatorin nazifashist dhe udhëhoqi luftën deri në çlirimin e plotë, ndërtoi socializmin në Shqipëri, duke zhvilluar një luftë të gjatë dhe të vështirë teorike dhe politike kundër revizionizmit dhe imperializmit. Tashmë kjo parti është riorganizuar dhe lufton për rindërtimin e socializmit në Shqipëri, ashtu si Partia Komuniste Italiane marksiste-leniniste drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm Domenico Savio. Si në gjithë



Nga transmetimi on-line, organizuar nga televizioni i Napolit midis Domenico Savio dhe Marko Dajti



Faksimile nga gazeta "Il Golfo"

Ballkanin edhe në Shqipëri ka probleme të shumta dhe na del detyrë e madhe dhe e vështirë për t'i përbaluar ato. Midis të tjerash biseda u përqendrua edhe në strategjinë që do të ndiqet për t'u bërë pjesëmarrës në zgjedhjet e ardhshme parlamentare që do të zhvillohen në muajin qershor në Shqipëri. U diskutua edhe për situatën politike në vend si edhe për reflektimin mbi llojin e politikës që mund të ndërtojmë ne si parti m-l. Duke qenë se të dyja partitë kanë web-site-in e tyre në internet bëhet edhe më i thjeshtë komunikimi dhe publikimi i materialeve të secilës palë dhe kjo, në njëfarë mënyre do të shërbejë edhe për shkëmbime të eksperiencave të reja bashkëkohore.

Më pas edhe shoku Domenico Savio përshkroi historikun e Partisë Komuniste Italiane, e cila është një parti e vjetër njësoj si PPSH, foli për punën, vështirësitë dhe luftën e madhe që iu është dashur të përballonin për të mbrojtur idetë e tyre revolucionare. U prekën gjithashtu periudha e luftës së Antonio Gramshit, për krijimin e kushteve të revolucionit socialist, për numrin e madh të të rënëve në këtë revolucion, për revizionimin e kësaj partie, për sensin borgjez dhe modifikimet e bëra nga udhëheqësit e mëvonshëm të saj. Ndërsa në 1989, theksoi ai, tradhtia e Masimo D'Alemës ishte një turp pa fund. Pas vështirësive të mëdha që dolën në këtë periudhë, u shpreh ai, ne kemi punuar dhe jemi përpjekur për 5 vjet me radhë për të ndërtuar një parti të vërtetë m-l në Padova, Palermo etj. Kjo bëri që ne të mendohej mirë sepse, duke u bazuar në shkrimet e Leninit dhe bolshevikët

bënë një parti të vërtetë revolucionare, dhe mendojmë se asnjë nga ne nuk mund të krijojë një të tillë pa e respektuar këtë vijë. Është e vështirë të rritet një parti e vërtetë, pa studiuar marksist-leninistët. Sot, e keqja më e madhe është revizionizmi, armiku ynë më i madh.

Prandaj, theksoi shoku Domenico Savio në mbyllje të fjalës së tij, dëshiroj të gjejmë gujshën e përbashkët pa patur kontradikta. Ne jemi të interesuar të kemi një marrëdhënie të mirë me PPSHR. Në punojmë në Itali dhe ju në Shqipëri duke u bazuar në vijën m-l, për të dhënë kontributin tonë ndërkombëtar dhe na përket neve të ndërtojmë një strukturë të re. Në kufijtë e forcës sonë, themi që të kemi forma dhe konsulta të vazhdueshme edhe nëpërmjet internetit, dhe, për të ndjekur gjërat që ndodhin duhet të jemi të gjithë të vetëdijshëm. Shumë sensacional do të ishte edhe transmetimi on-line, organizuar nga televizioni i Partisë Komuniste Italiane në pasditen e së dielës, 7 dhjetor 2008, në orën 18.00, drejtpërdrejt nga Selia Kombëtare e Partisë Komuniste Italiane M-L ku ndodhej i ftuar midis të tjerëve Sekretari i Parë i PPSHR shoku Marko Dajti dhe Domenico Savio, Sekretar i Përgjithshëm i PKI për të diskutuar për problemet politike, sociale, kombëtare dhe ndërkombëtare, për situatën aktuale politike në Shqipëri, një trasmetim televiziv ky që bëri jehonë dhe u pasqyrua përsëri në shtypin lokal "Il Golfo" të Napolit, në ditën pasardhëse, i shoqëruar edhe me fotot përkatëse të këtij takimi.

Një shëtitje e paharruar në ishullin e Ischias, që me të vërtetë do ta quaja ishulli i agrumeve, pasi në çdo hap të shoqëronin aroma portokajve, limonave, e mandarinave etj., karakteristikë kjo e shoqëruar edhe me ngjyrën e kuqe, me të cilën zbukuroheshin fasadat e jashtme të shtëpive të këtyre banorëve, vendosur në sfondin e ndritshëm dhe të magjishëm të detit blu që natyra ia kish thurur si kurorë.

Përveç kënaqësisë që morëm nga kjo bukuri e pakrahasueshme natyrore, kjo vizitë kishte një rëndësi të veçantë për partinë tonë, sepse aty gjetëm një burim eksperience dhe bashkëpunimi që do të na ndihmojë në punën tonë për të ardhmen, pse jo, gjetëm edhe një forcë të re ku ne të mbështetemi.

NGA BORANA VASO

PPSHR me rastin e Vitit të Ri 2009 i kanë ardhur shumë mesazhe urimi nga parti dhe organizata të ndryshme të botës komuniste, revolucionare të majta, në të cilat shprehet dëshira e tyre për forcimin e lidhjeve vëllazërore me Partinë tonë, duke na uruar suksese edhe më të mëdha në të ardhmen. Urime të tilla na kanë ardhur nga Kuba, Itali, Spanja etj.

**Redaksia**

## MESAZHE URIMI DHE PËRSHËNDETJEJE

### ORGANIZATËS KOMUNISTE TË GREQISË (KOE)

*Të dashur shokë!*

PPSHr ndjek me simpati të veçantë dhe përkrah pa rezerva protestat e drejta të popullit vëlla grek dhe të lëvizjes studentore, kundër shtypjes dhe shfrytëzimit kapitalist të regjimit të djathtë të Karemanlisit dhe të forcave të tjera të borgjezisë reaksionare greke si PASOK e të tjera. Dënojmë veprimtarinë e dëmshme oportuniste të disa forcave politike greke që bashkëpunojnë me regjimin në fuqi, për të zgjatur jetën e tij, duke u munduar të shuajnë flakët e lëvizjes studentore dhe të popullit grek që ka mbërthyer gjithë vendin, duke i denigruar manifestuesit si huliganë delikuentë, anarkistë e të tjera. E theksojmë edhe njëherë se solidarizohemi plotësisht me luftën tuaj të drejtë. Ne jemi me ju.

Sekretari i Parë i KQ të PPSHR  
**MARKO DAJTI**

### KOMITETI QËNDROR TË PARTISË KOMUNISTE TË KUBËS, ME RASTIN E 50 VJETORIT TË FITORES SË REVOLUCIONIT KUBAN

Komiteti Qëndror i Partisë Punës së Shqipërisë e Riorganizuar përshëndet përzemërsisht Komitetin Qëndror të Partisë Komuniste të Kubës me rastin e 50 vjetorit të fitores së revolucionit kuban nën udhëheqjen e komandantit Fidel Kastro dhe u dëshiron gjithë komunistëve dhe popullit kuban suksese edhe më të mëdha në ndërtimin e socializmit, në luftën e vendosur dhe pa kompromis kundër imperializmit janki dhe reaksionit botëror, në solidaritetin me luftën e popujve të shtypur dhe të shfrytëzuar të botës, në forcimin e unitetit të Lëvizjes Komuniste Ndërkombëtare etj. Jemi të sigurt se marrëdhëniet e miqësisë të bazuar në principet e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar midis dy partive tona do të forcohen më shumë dhe më mirë në të ardhmen.

Rroftë Partia Komuniste e Kubës, populli heroik kuban nën udhëheqjen e Komandantit Raul Kastro dhe miqësia midis dy partive tona motra.

Komiteti Qëndror i Partisë së Punës së Shqipërisë e Riorganizuar

Sekretari i Parë i KQ të PPSHR  
**MARKO DAJTI**

### QEVERISË SË VENEZUELËS ME RASTIN E 10 VJETORIT TË REVOLUCIONIT BOLIVARIAN

Me rastin e 10 vjetorit të Revolucionit bolivarian u dërgojmë përshëndetjet tona më të sinqerta, me dëshirën që të keni suksese në të gjitha fushat e jetës së vendit. Në këto 10 vjet lufte dhe pune të palodhur, nën udhëheqjen e liderit tuaj, shokut Hugo Çavez, Venezuela është shndërruar në simbol e në pararojë të luftës antiimperialiste, ka arritur një reputacion të shkëlqyer në arenën ndërkombëtare dhe në sajë të bashkëpunimit të ngushtë me Kubën revolucionare, kontributi tuaj në unitetin latino-amerikan, përmes organizatës "Alba", është shembullor dhe premtues për të ardhmen. Ne ndjekim nga afër dhe me simpati hapat pozitive përpara të revolucionit bolivarian dhe gëzohemi shumë për arritjet e tij, solidarizohemi me luftën e popullit venezuelian për konsolidimin dhe thellimin e transformimeve socio-ekonomike, antiimperialiste demokratike e socialiste.

Rroftë revolucionin bolivarian dhe udhëheqësi i saj shoku Hugo Çavez

Sekretari i Parë i KQ të PPSHR  
**MARKO DAJTI**

### POPULLIT PALESTINEZ NË RRYPIN E GAZËS

PPSHr dënon me forcë agresionin barbar të Izraelit i mbështetur nga imperializmi janki kundër popullit martir të Palestinës dhe veçanërisht të Gazës. Krimet e fundit të Tel Avivit kundër popullit të Gazës tregojnë hapur natyrën kriminale të regjimit Sionist, një vegël e SHBA, për të përçarë popujt arabë dhe shtypur luftën e tyre të çlirimit kombëtar. Ne mbështesim fort luftën heroike të popullit arab dhe solidarizohemi me kauzën e tyre të drejtë.

Rroftë popullit palestinez!  
Poshtë imperializmi!

Komiteti Qëndror i PPSHR

Mjaft më. Është koha që ta themi troç dhe me zë të lartë: Berisha, përveçse është në krye të kupolës mafioze në pushtet, njëherazi është edhe njeriu i serbëve dhe në shërbim të tyre. Ka gati 20 vjet që, në sjelljen e tij duket qartë se ka një mision: atë të shkatërrimit të vendit dhe të kombit shqiptar. Për këtë askush nuk duhet të ketë as dyshimin më të vogël. Dalja e çështjes së serbo-boshnjakut Damir Fazllic është një fakt i ri dhe një argument më shumë që tregon se Berisha është i tillë. Faktet në favor të këtij përfundimi nuk mund të kundërshtohen. Ç'farë lipset më shumë për ta vërtetuar këtë? Vetëm ata që nuk duan dhe që kanë përfituar nga kjo situatë mund të mos e pranojnë. Pa pasur mundësi që në një shkrim të përmenden të gjitha do të mjaftonte të ndalemi shkurtazi në disa prej tyre.

Që nga viti 1990-të është vënë re një dukuri interesante: sa herë ka qenë në siklet Beogradi, në Shqipëri kanë ndodhur ngjarje spektakolare, qw kanë tërhequr vëmendjen e kancelerive evropiane dhe të opinionit ndërkombëtar, duke filluar që nga 2 korriku i 1990-ës. Kur në 2 korrik të 1990-ës mblihdje e vendoste Kuvendi i Kaçanikut për të ardhmen e Kosovës, në Tiranë shpërthyen dyert e ambasadave, ku u dyndën me mijëra shqiptarë, për të ikur nga sytë këmbët, ndaj atëherë askush nuk u muar me atë çka po ndodhte në Kaçanik, por me ç'po ndodhte në Tiranë. Dukej sikur një dorë e stërvitur dhe e parapërgatitur drejtonte aksionin e ambasadave, i cili, përveç të tjerave synonte për të eklipsuar vendimet e Kuvendit të Kaçanikut. Ndonjëri mund të pyesë: ç'lidhje ka Berisha me 2 korrikun? Ashtu duket, por po të kemi parasysh se skenari që e solli në pushtet atë, fillon para 2 korrikut, vazhdon me të e deri në dhjetor të 1990-ës dhe, në jo pak raste Berisha i është referuar kësaj date, e ka

Nga HETEM HALILI

## Berisha njeriu i serbëve

vlerësuar dhe e ka mbrojtur me zjarr si një akt që çoi në ngjarjet e mëvonshme. Po t'i shtojmë kësaj edhe përsëritjen e situatave të njëjta pas 90-ës e këtej, atëherë nuk mund të mos na shkojë mendja për lidhjen midis këtyre ngjarjeve simetrike. Por ky nuk është rasti i vetëm. Që nga 90-ta e këtej shumë ngjarje në Beograd e në Tiranë kanë qenë në sinkron me njëra-tjetrën, si të kordinuara e të drejtuara nga një qendër e nga një dorë e vetme. Puna vajti deri atje sa, kur në 1998-ën UÇK-ja hodhi sloganin: "të çlirojmë Kosovën", Berisha iu përgjigj me sloganin tjetër: "të çlirojmë Tiranën". Nuk kishte ndihmë më të vyer për Beogradin se sa kjo thirrje. Tashmë, dihet nga të gjithë se thyerja e embargos së naftës përbën aktin më domethënës të lidhjes së Berishës me Milosheviçin dhe klanin mafioz serb. Në vitet 1992-1995, gjatë luftës në Bosnjë, Berisha theu embargon e naftës të vendosur nga OKB-ja kundër Serbisë, si masë ndaj saj, për luftën e padrejtë të Milosheviçit. Shqipëria e sunduar nga Berisha ishte i vetmi shtet që theu në atë kohë embargon e naftës, duke shkelur rregullin e vendosur unanimisht nga faktori ndërkombëtar. Për këtë, jo vetëm u alarmua dhe ndërhyri OKB-ja, por shkruan gjerësisht në kujtimet e tij edhe një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Milosheviçit, Bulatoviç, i cili tregon se si hynë në marrëveshje me Berishën për të furnizuar me naftë Serbinë. Berisha, i zënë ngushtë, u detyrua ta pranojë se e kishte shkelur embargon dhe e kishte furnizuar me naftë Serbinë, por u justifikua se këtë e kishte bërë për t'i ardhur në ndihmë Kosovës

për ngrohje! Një deklaratë absurde, me të cilën ai tallet dhe ofendon kosovarët, njëherazi është edhe një pseudoalibi që më tepër vërteton thyerjen e embargos për t'i ardhur në ndihmë Milosheviçit në këto vite të vështira për të, se sa për ta mohuar dhe fshehur krimin. Si mund të ndihmohej Kosova përmes Malit të Zi ku sundonte miku më i ngushtë e më besnik i Milosheviçit, Bulatoviçi!? Këtë vetëm Berisha mund ta kuptojë e mund ta thotë. Në të vërtetë naftën e dhuruar nga Berisha, Milosheviçi e përdori për të vënë në lëvizje makinën e egër luftarake kundër boshnjakëve. Në këtë kuptim Berisha është bashkëpunëtor dhe bashkëfajtor në krimet e kryera nga Milosheviçi kundër civilëve të pafajshëm në Bosnjë. Nga kjo naftë, ndoshta Milosheviçit i ngeli një pjesë, për ta përdorur në luftën kundër Kosovës. Nuk qëndron as ajo që thotë Berisha se e bëri për t'u ardhur në ndihmë fshatarëve të varfër në zonat veriore. E vërteta është se karvanët me naftë u monopolizuan nga kompania "Shqiponja" e PD-së dhe, edhe sot e kësaj dite nuk dihet se ku shkuan të ardhurat që u siguruan nga kjo aferë e pistë e antishqiptare.

Në kuadrin e shërbesave për Serbinë e për Milosheviçin bëjnë pjesë edhe qëndrimet e mëvonshme të Berishës. Këtu inkuadrohen përpjekjet e tij për të penguar luftën e UÇK-së, duke e akuzuar këtë herë si me frymëzime islamike, e herë si me frymëzime marksiste-leniniste dhe enveriste, duke ditur ndjeshmërinë e faktorit ndërkombëtar nga alergjia antikomuniste. Në pragun e shpërthimit të luftës në Kosovë,

brenda vendit Berisha ndërmori e kreu një sërë veprimesh për të tërhequr vëmendjen, kulmi i të cilave arriti me kryerjen e grushtit të shtetit të 14 shtatorit, organizuar edhe me ndihmën e forcave dhe të miqve të tij kosovarë, që ishin kundërshtarë të UÇK-së dhe të luftës së armatosur. Më tej akoma, Berisha u përpoq për të sabotuar, me aq sa mundej, Konferencën e Rambujesë. Dihet këshillat dhe presioni i tij, përmes emisarëve të dërguar atje, ndaj delegacionit kosovar për të mos e firmosur këtë marrëveshje. Pas ardhjes në pushtet, në vitin 2005, atëherë kur diskutohej për dhënien e pavarësisë së Kosovës, shteti berishian, në emër të një roli stabilizues në rajon, përkundër deklaratave demagogjike në ndihmë të saj, nuk bëri asgjë, vetëm heshti dhe deklaroi se ishte dakord me ç'farëdo zgjidhje që do t'i jepte faktori ndërkombëtar kësaj çështjeje, në një kohë kur duhej të ishte një faktor i fuqishëm, duke shtruar jo vetëm nevojën e pavarësisë, por edhe atë të bashkimit me Shqipërinë. Po kush ta bënte, ai që i shërbente me zell Serbisë? Veç këtyre qeveria e Berishës, përmes Ministrit të saj të Jashtëm z. Mustafaj, nxori alternativa që ishin kundër interesave të Kosovës, siç qenë ato të pavarësisë së kushtëzuar apo deklarata që e siguronte Vuk Drashkoviçin se nuk do të ketë dy shtete shqiptare, të cilat z. Mustafaj nuk mund t'i ketë bërë pa dijeninë dhe pa bekimin e Berishës. Të gjithëve nuk mund të mos na kujtohen qëndrimet e tij kur pyetej për pavarësinë e Kosovës. Në vend që të përgjigjej për të, kalonte

menjëherë tek nevoja për të siguruar të drejtat e serbëve. Nuk thonë kot: "tek dhemb dhëmbi vete gjuha".

Për të mos u zgjatur, ngjarja e fundit me Fazllicin hoqi ç' do dyshim dhe nxori në dritë të diellit lidhjet e Berishës me faktorin më të errët serb, me klanin e Zemunit, për të cilin, për alibi, fliste shumë dhe akuzonte të tjerët, por që siç duket doli i lidhur këmbë e kokë vetë. Lidhja me Damir Fazllicin, deklarimi si mik i tij dhe i familjes, falja për një euro e qindra hektarëve tokë në Porto Romano mikut të tij Damir, importi i energjisë elektrike me çmim të kripura, nga Serbia, lejimi i bizneseve serbe për të kontrolluar ekonominë shqiptare, flasin qartë e janë fakte që nuk duan koment. Tani këto tashmë dihen mirë nga të gjithë. Frika dhe alarmi që e kapi kur hyri në lojë prokuroria, reagimi për ta patur në dorë e nën kontrollin e tij, këtë të fundit përmes Nishanit e Alibeajt, sulmi ndaj Prokurorisë dhe Ina Ramës tregojnë se diçka të pistë e të rëndë kërkon të mbulojë. Makthi që e ka kapur dhe veprimet e pa kontrolluara që po ndërmer e komprometojnë më shumë se sa heshtja. Aq keq duhet të jetë lidhur Berisha me Fazllicin, e me Serbinë në afëri të pista korrupsioni e krimi në dëm të interesave kombëtare, sa që duket sikur nuk di nga t'ia mbajë. Duket qartë që ai është i lidhur ngushtë me Serbinë e serbët. Këtu ka shkuar aq thellë sa e ka të pamundur të kthehet prapa dhe, as që mund të kërkohet kjo prej tij. Çështja shtrohet se:

A do të dalin në dritë këto lidhje, apo edhe kësaj here do ta kalojë lumin pa u lagur, siç ka bërë edhe herë të tjera? Kësaj panorame bashkëpunimi me Serbinë, në qoftë se i shtojmë edhe lidhjet e lëshimet skandaloze fqinjit të jugut, për të cilat kemi shkruar gjerësisht herë të tjera, atëherë del më i plotë rreziku që i kanoset vendit nga kjo bandë antikomëtare në pushtet.

## Në parlament për Shqipërinë dhe popullin

← vijon nga faqja 3

gënjyer popullin për 18 vjet me radhë.

Duhet të punojmë intensivisht për të rritur në një shkallë më të lartë rolin e çdo anëtar të PPSHR në çdo organizatë bazë dhe shokëve të zgjedhur, që secili të kryejë me përgjegjësi detyrën e ngarkuar. Fushata e zgjedhjeve parlamentare na vë para detyrash të reja dhe të vështira, veçanërisht për shtimin e organizatave në ato lagje dhe fshatra ku nuk kemi, të punojmë për forcimin e organizatës së rinisë dhe asaj të gruas. Nuk është e mjaftueshme të pranojmë vetëm teorikisht rolin e Partisë, por ajo duhet vënë praktikisht në udhëheqje të fushatës elektorale. Çdo organizatë bën një analizë të arritjeve të dëritanishme dhe përcakton detyra dhe objektiva të reja, duke i shoqëruar ato me masa të plota tekniko-organizative, propagandistike.

Për të kurorëzuar me sukses fushatën dhe për arritjen e objektivave tona kërkohet një organizim dhe disiplinë, një ndjenjë e lartë përgjegjësie. Pa humbur kohë

të ngrejmë dhe shikojmë funksionimin e shtabeve elektorale, që nga organizatat bazë të Partisë në Komuna dhe në Bashki, të cilat ndjekin çdo ditë ecurinë e fushatës dhe të merren masa në ato raste kur punët nuk ecin mirë.

Detyra kryesore dhe urgjente për çdo organizatë dhe anëtar të Partisë është verifikimi dhe njohja e gjendjes, puna kokë më kokë me njerëzit në lagje, fshatra, në grupe e persona të veçantë, në rrugë, në pallate ku banojmë, në familje, në rrethin tonë familjar dhe shoqëror. Vërtet kemi vështirësi të mëdha financiare, gjë të cilën partitë e mëdha nuk e kanë problem aspak, por kjo nuk do të na pengojë ne të organizojmë dhe programojmë punën në këtë mënyrë. Puna jonë duhet të depërtojë tek njerëzit e lëkundur, tek ata që janë zhgënjyer nga partitë e mëdha, t'i bindim ata që inatin ndaj tyre të mos e shprehin duke braktisur kutinë e votimit, por të gjejnë zgjidhjen e duhur, të votojnë për Partinë e Punës të Shqipërisë e Riorganizuar. Ne jemi të ndërgjegjshëm se pengesa do të ketë, prandaj duhet që në qendrat e votimit të kemi njerëzit tanë më

besnikë, trima e të palëkundur, të ndërgjegjshëm dhe të pakorruptueshëm, vigilentë, në mënyrë që votën tonë ta ruajmë si sytë e ballit.

Është momenti të tregojmë forcën dhe pjekurinë e Partisë sonë, si parti marksiste-leniniste, sepse ne kemi forca dhe energji të përballojmë çdo pengesë dhe vështirësi, se jemi parti e njerëzve të ndershëm, të pararojës, e njerëzve të guximshëm, e atyre që sakrifikojnë për bindjet e tyre. Nga sondazhet e bëra, na rezulton se në disa rrethe si Tirana, Durrësi, Fieri, Berati, Vlora, Korça e Shkodra do të marrin votat e nevojshme për të futur në parlamentin shqiptar deputetët e tyre.

Në këtë veprimtari propaganda ka rëndësi të madhe, kërkohet shumë durim, zgjuarsia, duhen vënë në dukje arritjet e viteve të socializmit përballë kësaj katastrofe që po përjeton populli ynë në këto vite të pseudodemokracisë si varfëria e tejskajshme, asfiksimi i plotë i ekonomisë shqiptare, kriminaliteti në rritje, korrupsioni, kontrabanda, prostitucioni, pasiguria e jetesës. Këto argumente që janë në favorin tonë për të luftuar kundërshtarin duhet të dimë t'i përdorim në fushën e propagandës së Partisë sonë. Të luftohet mendimi se nuk kemi kandidatatura të mundshme për të konkurruar. Jo! PPSHR në të gjithë Shqipërinë ka mundësi dhe forca intelektuale e

njerëzore për ta përfaqësuar atë me dinjitet. Në radhë të parë kemi njerëz me figurë të pastër dhe të papërlyer në afëri të pista, njerëz që dinë se ç'tu tregojnë popullit dhe mundësitë që i ofrojnë atij në të ardhmen, njerëz që i kanë qëndruar besnikë mësimëve të shokut Enver, prandaj një rëndësi të veçantë ka përgatitja e kandidatëve dhe prezantimi i tyre në popull si njerëz që dinë të argumentojnë fenomenet me të cilat përballen çdo ditë shqiptarët. Kjo kërkon që për secilën zonë, komunë e bashki të nxirren shifra dhe fakte për varfërinë, papunësinë, korrupsionin, kriminalitetin, shpërdorimin e fondeve publike, duke i vënë ata kështu, përballë një të vërtete të pamohueshme. Për një ecuri normale gjatë fushatës duhet t'i dërgohet një informacion të vazhdueshëm Komitetit Qëndror të Partisë, sepse vetëm në këtë mënyrë puna ndërtohet më mirë. Aleati ynë kryesor në këto zgjedhje është populli i thjeshtë, sidomos të papunët, punëtorët e fshatarët, njerëzit e ndershëm. Kjo duhet kuptuar mirë jo vetëm teorikisht por edhe praktikisht, sepse çdo ditë që kalon, njerëzit e thjeshtë po bëhen më të ndërgjegjshëm për rëndësinë e votës së tyre.

U bëjmë thirrje gjithë ish-anëtarëve të PPSH, të cilët u rritën, u shkolluan dhe u bënë kadro në atë periudhë, të afrohen dhe të shlyejnë sadopak borxhin e madh që

i kanë PPSH dhe shokut Enver, duke marrë pjesë aktivisht në takimet e përbashkëta, duke shkuar tek kutia e votimit dhe duke i dhënë votën Partisë së Punës së Shqipërisë e Riorganizuar dhe së bashku të japim kontributin tonë për çështjen e madhe të popullit dhe atdheut tonë fatkeq që, prej 18 vjetësh rënkon nën shtypjen dhe shfrytëzimin fashisto-borgjez.

Shqipëria dhe populli shqiptar sot kërkon një forcë politike që t'i dalë zot vendit, një parti politike që e thotë të vërtetën, që është në gjendje të marrë në dorë fatet e popullit dhe të kombit shqiptar. Kjo forcë politike është Partia e Punës e Shqipërisë e Riorganizuar, prandaj ta forcojmë, ta ruajmë partinë tonë, të mbështesim njëri-tjetrin dhe të kryejmë më së miri misionin e madh që kemi marrë përsipër, duke punuar dhe votuar për PPSHr, për një Shqipëri pa shtypës, ku të mbizotërojë qetësia dhe jeta e lumtur e shqiptarëve. Le të punojmë, sepse me ne është e drejta, se jemi gjallë akoma, jemi më të fortë, më të bashkuar se kurrë. Emri i Partisë së Punës së Shqipërisë e Riorganizuar është i madh, është krenar, i lavdishëm dhe i tillë do të mbetet në të gjitha gjeneratat, ndaj ne e kemi për nder të jemi anëtarë të saj dhe vazhdues të denjë të veprës së shokut Enver Hoxha.

NGA MUHO ASLLANI,  
Sekretar Politik i PPSHR

# Balli (anti) Kombëtar "kobure" për okupatorët nazifashistë

Nga DHIMITËR TOPUZI

Rritja e vullshme e LANÇI në udhëheqjen e PKS, formimi i Frontit Antifashist Nac-Çl, lufta partizane që rritej, njohja si pushtet i Këshillave Nacional-çlirimtare, në fund të vitit 1942, solli një krizë të thellë politike në radhët e armiqve dhe të reaksionarëve, të cilët kishin lidhur fatin me pushtuesit. Reaksioni dha alarmin se vendit po i kanoset "rreziku komunist", prandaj, në fund të nëntorit 1942, me një trakt "Lufta për çlirimin kombëtar" shpallën krijimin e një organizate politike që u quajt "Balli Kombëtar" me programin e saj "Dekalogun". Në pikën e fundit "Dekalogu" përmendte shkarazi "mobilizimin e kombit kundër pushtuesit". Por cili ishte ky pushtues nuk cilësohej dhe nuk bëhej fjalë për luftë të armatosur. Ata shpërthyen në një fushatë të shfrenuar kundër Frontit Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe PKS. "Balli Kombëtar" përhapte parrulla kundër luftës me armë: "nuk ka ardhur koha për luftë kundër italianëve, kur të vijë koha ne do të jemi në ballë, prandaj duhet të presim...", komunistët po na marrin në qafë duke luftuar italianët, duhet t'ua ndalim dorën". Me këtë propagandë disfatiste, "Balli kombëtar", krijoi disa çeta "ilegale" në disa fshatra dhe këshilla të "Ballit". Parrulla e tyre ishte "Jemi për Shqipërinë e lirë, Shqipërinë etnike". Në krye të "Ballit" dolën dhe të gjithë ata që në qeverinë e Mustafa Krujës (dhjetor 1941-janar 1943) ishin pjesëtarë të kësaj qeverie si: Qazim Koçuli, Hasan Dosti, Jup Kazazi (ish-ministra); Bahri Omari, Kol Tromara e Rexhep Mitrovica (ish-këshilltarë shteti); Faik Quku e Rasim Babameto, ish-prefekt e kryetar bashkie; Koço Muka e Azis Çami ishin kuestorë; Ali Këlcyra tregtar i madh, shfrytëzues i pasurive kombëtare dhe i punonjësve të varfër. Mustafa Kruja, më 13 prill 1943, në gazetën "Roja kombëtare" ka shkruar se "Ali Këlcyra e Qazim Koculi, më 1938 i kanë kërkuar Musolinit të dërgojë në Shqipëri një princ nga gjaku i Savojës, për ta bërë mbret të Shqipërisë. Ballistët nuk njohën Konferencën e Pezës dhe vendimet e saj. Në qarkoren e "Ballit" 6/11/1942 shkruhet: "Për me mujt me pasë një forcë mbrojtëse e veprimi ashtu dhe në rast nevojë me mujt me marrë përnjëherë në dorë situatën në secilin qytet, lypset përgatitja e forcave të armatosura, gati për çdo eveniment". Në trakt nuk bëhet thirrje për të luftuar okupatorin, por lihej të nënkuptohet që do të luftohet kundër Ushtrisë Nac-Çl. Fashistët italianë vendosën lidhje me ballistët në janar 1943 nëpërmjet anëtarit të "thekur" të "Ballit", Maliq Bushatit, kryeministrin kuisling, i cili e ndihmoi "Ballin" me para nga fondi sekret i qeverisë si dhe armatosjen e çetave balliste.

Lindja e "Ballit" e ndërlikoi gjendjen. Në shtesa të ndryshme të popullit u shkaktua paqartësi, ballistët bënë për vehte një pjesë të popullsisë në disa qytete, por më tepër në fshat. Në këto kushte PKS përcakttoi qëndrimin e saj: "Të



Ballistët gjatë një operacioni gjerman në Shqipëri

*Në të gjitha aksionet e kryera kohët e fundit nga UNÇL janë ndeshur me trupa të përziera gjermane dhe balliste të armatosura mirë, të stërvitura nga gjermanët... ballistët kanë dhënë prova për bashkëpunim të ngushtë me gjermanët. Gjenerali Dejvis, i ndjekur dhe i plagosur në malet e Çermenikës nga çeta balliste e Azis Biçakut u kap dhe iu dorëzua gjermanëve. Këta e dërguan në spitalin e Tiranës për mjekim.*

demaskohet parrulla disfatiste e "Ballit" se "s'ka ardhur koha për luftë kundër italianëve". "Balli" të pranojë bashkimin e të gjitha "forcave antifashiste në luftë kundër fashistëve italianë", të pushojë propagandën kundër PKS, të bëhen bisedime për çështje të luftës kundër pushtuesve, disa krerë të "Ballit" të kompromentuar si profashistë e tradhëtarë të demaskohen para popullit".

Ballistët në fillim të 1943, si i thonë fjalës, "morën derën në krahë", së bashku me okupatorin organizuan luftën kundër Lëvizjes Nac-çl. Më 17 shkurt 1943, siç deklaroi komanda ushtarake italiane e Fierit, "u paraqitën në mënyrë vullnetare pranë kësaj komande Bektash Cakrani, Egerem Peshkëpia, Qazim Selfo etj., dhe nënshkruan një marrëveshje". Në pikën 3 ballistët angazhoheshin: "të shpirtallojmë rrebelët (vetëkuptohet, partizanët), kur janë në grupe të vogla, pa patur nevojë të kërkojmë ndihmë prej ushtrisë"; në pikën 7: "të jemi gjithmonë gati për të bashkëpunuar dhe ndihmuar ushtrinë italiane në rast nevojë"; në pikën 8: "duke filluar qysh nesër, të japim emrat e fshatrave (të lidhur me Lëvizjen Nac-Çl) që nuk do t'u binden këtyre detyrimeve...". Protokollin ndodhet në AQS, Fondi 254, Dosja 170, 17 shkurt 1943.

Kryeministri Maliq Bushati, më 5 mars 1943, në mënyrë zyrtare, shtron një darkë për nder të gjeneral Dalmacos, mbasi ishte konkluduar protokollin Dalmaco-Këlcyra. Komanda kolaboracioniste shqiptare, në maj 1943, njoftoi: "Ali bej Këlcyra kërkoi pushimin e veprimit ushtarak, duke siguruar se të 22 katundet kishin pranuar të merrnin pjesë në "besën", duke ç'mobilizuar çetat", më 4 maj 1943,

njofton: "Ali bej Këlcyra, në fjalën e tij në Damës të Tepelenës ka nxitur popullin të bashkëpunojë me autoritetet në luftë kundër komunistëve". Më 29 maj 1943 kjo komandë njofton: "Ali bej Këlcyra me aktivitetin antikomunist ka patur rezultate të mëdha, çetave të armatosura nacionaliste u ka dhënë gradualisht një karakter të theksuar antikomunist": Safet Butka, më 20 maj 1943 njofton nënprefektin e Kolonjës: "...para pesë ditëve luftuan kundër komunistëve në Bulgarec të Korçës". Në gusht 1943, Safet Butka në fshatin Rrëmbec, bazë e Frontit Antifashist Nac-Çl, kërkon t'u dorëzohet ballistëve 300 kv grurë. Fshati rrethohet nga çeta partizane e "Gorë-Oparit" dhe detyron ballistët të dorëzojnë grurin e grabitur fshatrave. Safet Butka, meqë e pa veten të rrethuar e të turpëruar, vari veten në nevojtoje. Në prill 1943 komandantët ballistë të zonës Qukës-Bërzhëzhtë, si Nezir Muzhaqi, Haki Blloshmi e Hasan Velçani, nuk pranuan të ndërmerrnin aksione të përbashkëta me partizanët, mbasi "nuk ka ardhur koha". Ballistët nuk pranuan aksion të përbashkët me partizanët tek Tri Urat në Qukës dhe deklaruan se, në rast të kundërt "do t'u biem partizanëve prapa krahëve". Ky qëndrim bëri që aksioni të bëhet në vend të papërshtatshëm, në Pojskë, ku mbetën 10 dëshmorë partizanë.

"Po për ju zoti Butka, që me 600 e ca faqe libri, fallsifikoni të vërtetat historike të LANÇ-it, kur duhej të vinte koha për të luftuar okupatorin??!" "Beteja e Pojskës zhvillohet 9 ditë para se të bjerë Musolini dhe 53 ditë para se të kapitulohet Italia. Dhe sa ditë duhej të prisnin ballistët që të vinte dita dhe së dyti, me çfarë merreshin "çetat" balliste në këto ditë, kur

okupatori po përpiltej në shtratin e vdekjes?! Mbas kapitullimit të Italisë "patriotët" ballistë si Mit'hat Frashëri, Vasil Andoni, Thoma Orogolli, Nexhat Peshkëpia e Ali Këlcyra shkuan nga zona e Shëngjergjit dhe e Zaranikës për të prishur Këshillat Antifashiste Nac-Çl, për të krijuar një qendër të tyre "ilegale", por nuk gjetën përkrahjen e popullit. Shtabi i Përgjithshëm njofton: "Njerëz të "Ballit" kanë dalë në zonën e Zaranikës të prishin me forcë Këshillat Antifashiste Nac-Çl. Të ndëshkohen iniciatorët, por mos harrohet lufta kundër okupatorit, armikut kryesor". "Balli" mendonte se në mbledhjen e Mukjes do të merrnin në dorë situatën me "Komitetin për Shpëtimin e Shqipërisë", ku fjalën e parë dhe të fundit do ta kishin ballistët, por "fjala e parë" përfundoi keq. Ata propozuan që delegacioni i Frontit të përbëhej nga 6 anëtarë, ai i "Ballit" nga 12, pasi pretendonin se ishin shumica, sepse me krijimin e "Ballit" patën pretenduar: "Ai shqiptar që nuk është komunist është me "Ballin". Por dënimi i menjëhershëm i marrëveshjes së Mukjes nga organet drejtuese të LANÇ-it dhe nga Enver Hoxha, si një akt tradhtie pengoi realizimin e qëllimeve të "Ballit". Ali bej Këlcyra, më 25/9/43, njofton KQ të "Ballit": "Populli i Gjirokastrës na bojkoton në një mënyrë të çuditshme, ai e urren organizatën e "Ballit", sepse është kompromentuar rëndë, pjesëtarët e LANÇ-it po i përkrahin dhe janë më të fortë moralisht se ne". Mbas Mukjes, ku "Balli" "shkoi përlesh dhe doli i qethur", filloi propaganda diskriminuese për PKS, gjoja ajo ishte "shkaktare e përcarjeve, nxiste vëllavrasjet etj".

Më 1/9/43 çeta balliste e Fuat Eçmenikut vret kyetarin e Këshillit në Tren (Korçë), Rifat Treni dhe komandantin e njësitit gueril Beqir Strapani. Mbi trupin e tyre lihet një letër: "U çekzekutuan për hakmarrje. Ky dënim do t'u jepet të gjithë atyre të anës tjetër". Më 6 shtator 1943 goditet nga çeta balliste për të dytën herë, pas shpine, batalioni "Hakmarrja" në afërsi të Gostivishtit nga çeta e Xhafer Butkës. Të gjitha këto veprime terroriste dhe antikombëtare bëheshin ndaj ushtrisë partizane çlirimtare të njohur botërisht nga fuqitë e koalicionit antinazi-fashist Rusi, SHBA, Angli. "Balli" pas Mukjes, për të përforcuar pozitën e tij me Mit'hat Frashërin në krye, shkuan në zonën e Veriut, mbasi disa krerë reaksionarë të kësaj zone ishin rezerva e fundit e "Ballit". Më 28 gusht 1943 ishin në Lurë të Dibrës, më 21 shtator krijuan të ashtuquajturën "Lidhje dibrane". Në pikën e parë dhe të dytë shkruhej: 1. "Organizata komuniste me çdo emër dhe çdo moshë që të shfaqet, është më i pari rrezik...". 2. "Në rast të një veprimi të përbashkët, grupi pranon që një veprim i këtillë të bëhet në emër të Ballit Kombëtar...". Mbledhje të tilla i bënë dhe në Dukagjin e Koplik, të gjitha drejtoreshin e bëheshin në emër të "Ballit", kundër PKS dhe UNÇL.

Në shtator 1943, i dërguari i posaçëm gjerman deklaroi: "Mos zbarkimi anglo-amerikan ka influencuar në afrimin e njerëzve. Bandat nacionaliste kanë lajmëruar

me anën e Mehdi Frashërit se nuk do të bëjnë asnjë akt armiqësor kundër ushtrisë gjermane, disa nga këto formacione kanë shprehur gatishmëri të pranojnë luftën kundër bandave komuniste. Suksesi ynë kundër komunistëve nuk mund të sigurohet pa ndihmën e shqiptarëve" (e këta shqiptarë ishin ballistët). Bashkëpunimi i çetave balliste me pushtuesit gjermanë kundër UNÇL u zgjerua pas qarkores së 7 tetorit 1943 të Komitetit Qëndror të Ballit Kombëtar, sipas së cilës forcat e "Ballit" urdhëroheshin për të sulmuar forcat partizane dhe për të bërë një propagandë sistematike kundër PKS dhe Ushtrisë Nac-çl. Balli kombëtar dhe grupet e tjerë jashtë Frontit luftuan si vegla të pushtuesve. Partia Komuniste e Komanda e Përgjithshme e UNÇL nuk e quajtën asnjëherë me vend të ndryshonin platformën e Konferencës së Pezës e të hidhnin parrulla kundër bejlerëve, borgjezisë, bajraktarëve etj. Për këtë arsye, lufta me armë që vazhdonte midis popullit me partinë në krye nga njëra anë dhe okupatorit, Ballit e pjesës tjetër të reaksionit nga ana tjetër, nuk ishte luftë civile por çlirimtare. PKS pati deklaruar: "Grindje të brendshme në Shqipëri dhe ca më pak luftë civile nuk ka, ka vetëm një luftë: luftë kundër okupatorit në radhë të parë dhe kundër veglave të tij tradhtarë". Reginald Hilbert në librin: "Fitorja e hidhur", veç të tjerave shkruan: "Sasia e furnizimeve gjatë prillit 1944 për partizanët e Luftës NAÇL 27.8 ton ishte ende modeste në krahasim me luftimet që ato bënin dhe me nevojat urgjente që kishin për armë, municione, veshje, këpucë e ilaçe". Kryetari i misionit anglez në Shqipëri, gjenerali Dejvis, më 17 dhjetor 1943 njoftonte shtabin e tij në Kajro: "Ka ndodhur një evolim i shpejtë i situatës dhe radikal, rekomandoj të denoncohet Këshilli i Regjencës emër për emër, po ashtu Ballkomi dhe zogistët. Në të gjitha aksionet e kryer kohët e fundit nga UNÇL janë ndeshur me trupa të përziera gjermane dhe balliste të armatosura mirë, të stërvitura nga gjermanët... ballistët kanë dhënë prova për bashkëpunim të ngushtë me gjermanët". Gjenerali Dejvis, i ndjekur dhe i plagosur në malet e Çermenikës nga çeta balliste e Azis Biçakut u kap dhe iu dorëzua gjermanëve. Këta e dërguan në spitalin e Tiranës për mjekim.

Në librin e tij, Dejvis shkruan: "Në spital ndodheshin 150 shqiptarë të plagosur, të gjithë ballistë e zogist, kjo provon se cili bashkëpunon me gjermanët dhe cili jo". Vlen të theksohet se nazistët gjermanë nuk mund t'i bënin ballë luftës të vetëm, prandaj vërejnë: "suksesi ynë kundër komunistëve nuk mund të sigurohet pa ndihmën e bashkëpunësorëve shqiptarë, dhe se nacionalistët e ballistët nuk mund të jetojnë pa ndihmën gjermane" (Raporti i komandës gjermane, Korpusi XXI). Paturpësia e "Ballit Kombëtar" në shtator 1943 arriti sa të deklarohet se "organizata jonë është në luftë me okupatorët e rinj, me UNÇL dhe do të godasë këdo që të takojë. (Qarkore e Ballit Kombëtar. Gjirokastrë dt. 26/9/1943".


I dërguari i posaçëm gjerman për juglindjen, Neubacher, ka deklaruar: "Balli kombëtar nuk luftoi kurrë kundër trupave tona".

Ja, kjo është dhe e vërteta mbi "Ballin Kombëtar", që në fakt ishte "Balli antikombëtar" dhe bashkëpunëtor i pushtuesve nazifashistë.

# “Shëndet dhe pleqëri të mbarë shoku AZIS!



# Qofsh përherë i gëzuar dhe paçi mirësi



Azis Ismail Qorraj

Azis Ismail Qorraj u lind më 10/12/2008 në Vranisht të Vlorës në një familje atdhetare. Nga stërgjyshi, brez pas brezi kanë qenë pjesëtarë të Çetës së Vranishtit, me armë në dorë, sa herë që e ka dashur historia, në luftë kundër pushtuesve turq, shovinistëve grekë, pushtuesve italianë e gjermanë. Pasi jetoi fëmijërinë në fshatin e lindjes, moshën e adoleshencës e kaloi në Dhërmi. Nuk mundi të arsimohej në ato vite të vështira. Në moshën 15 vjeçare zbriti në Vlorë, ku kreu punë të ndryshme. Me pushimin italian njohu shtypjen dhe shfrytëzimin kapitalist duke punuar në Fabrikën e Vajit, në Gurroren Drashovicë, në firmën italiane "Poliçeli" të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve.

Në vitet 1939-1941 Azisi bie në kontakt me Lëvizjen Punëtore dhe të Rinisë Antifashiste në Vlorë. U njoh me drejtues të kësaj lëvizjeje, e veçanërisht me shokun Hysni Kapo. Periudhën e luftës italo-greke e kaloi në ilegalitet, sepse kërkonin ta dërgonin ushtar në front. Në vitet 1942-1943 "Besniku" (H. Kapo), duke parë zgjuarsinë dhe trimërinë e Azisit

e ngarkonte me detyra e me porosi të veçanta, të cilat i kryente me sukses. Me formimin e çetës "Sali Murati" në Vranisht, Azisi u rreshtua efektiv i saj. Në luftën e Drashovicës, ku "Besniku" u plagos dhe shkoi në detyrë të re. Më 20 janar 1944 u rreshtua në batalionin e IV të Brigadës së V Sulmuese "Heroinë e Popullit". Ajo brigadë kreu luftime jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë e Bosnjën Jugore. Azisi u plagos dy herë: Në Kukës e më pas në rrethinat e Gjakovës. Në shtator 1944 Azisi u pranua anëtar i PKSH. Për guximin dhe trimërinë në luftë është graduar oficer dhe kapiten i parë. Mban disa medalje dhe urdhëra të fituara në luftë e në punë. Në vitin 1956 doli në lirim. Punoi në ekonomi në rrethet Shkodër, Lushnjë, Vlorë, ka qenë i pari në sakrificë e i fundit në pretendime. Me daljen në pension aderonte në Organizatën e Veteranëve të LANÇ-it, ku jep kontributin e vetë. Ai vazhdon të bëjë jetën e partisë në një organizatë të PPSH të Riorganizuar në Vlorë. Këto vite të ashtuquajtur "Tranzicion" Azisi i quan PËRMBYSJE. Ndjen dhimbje të thellë për mohimin që i bëhet LANÇ-it kundër nazifashizmit dhe bashkëpunëtorëve ballistozogistë, pinjollët e ballisto-zogistëve tentojnë ta rishkruajnë historinë duke e quajtur LANÇ-in si "luftë civile". Përbaltën heronjtë dhe dëshmorët e LANÇ-it si dhe veteranët e saj. Pushtetarët e këtyre 18 viteve kanë mohuar datat historike që shënuan kthesën e madhe në historinë e Shqipërisë si: 10 korrikun 1943, 24 majin, 11 janarin-Ditën e Shpalljes së Republikës etj.

E falënderojmë shokun Azis për këshillat e mira që u jep edhe nxënësve në shkollat e qytetit, sa herë e ftojnë për datat historike.

Në 87 vjetorin e lindjes i urojmë shokut Azis Qorraj:

**Shëndet dhe pleqëri të mbarë!**

Nga: Arshi GAMAJ

## In memoriam: ALI TEME ZAIMI

(dëshmor i atdheut, në 65 vjetorin e rënies, 21 janar 1944-2009)

65 vjet më parë Ali Zaimi, kur kishte mbushur të 18 pranverat, i rreshtuar si partizan me grupin e tretë të Skraparit, luftoi heroikisht dhe dha jetën në lulen e rinisë, në betejën legjendare të Tendës së Qypit.

Ishte djalë i vetëm i nënë Refikos, hallës tonë nga Hatellarët e Koritës. Si gjithë nënat shqiptare, e donte djalin e vet si dritën e syve, por LANÇ ishte gur i pronës për çdo shqiptar patriot, prandaj dhe Aliu, pasi përqafoi të emën, në acarim e janarit 1944, u inkuadrua me grupin e 3-të partizan të Skraparit që u krijua më 17 janar 1944. Në janar të vitit 1964, im atë më thotë se do të shkonim në fshatin Dobrush, tek halla Refikua, për të kujtuar 20 vjetorin e rënies në luftë të Aliut. Pasi mbërritëm, halla na doli përpara dhe na përqafoi me mall. Atë ditë erdhën edhe të afërm të tjerë, nipërit me të cilët jetonte, Jashari, Petriti, Fatmiri dhe nga Korita, Rexhepi, Zaimi, Xhelali e të tjerë.

- Jo kaq sa Demirin e kisha Aliun, - na tha hallua dhe pa me mall nga fotografia e të birit që e kishte vendosur në mur. Pastaj na propozoi të shkojmë tek Aliu.

- Është larg? - e pyeta unë.

- Jo, - tha. - E kemi vendosur këtu, pranë dritares.

- Pse nuk e kanë vendosur në varrezat e dëshmorëve?! - pyeta i habitur.

- E lanë me kërkesën e Refikos, - tha babai - pasi duke e patur këtu, ajo çmallet me djalin.

Sapo dolëm në oborr, në të djathtë, fare pranë dritares, ishte vendosur qivuri i Aliut dhe në krah qëndronte një bajame, degët e së cilës dukej sikur e mbronin nga rreshjet e dimrit dhe zhegu i vapës. Aty halla nisi të kujtojë: "Janari i atij viti ishte shumë i

acartë dhe dëbora kishte mbuluar malet. Flitej se forcat gjermano-balliste do të sulmonin Skraparin, (operacioni i dimrit). Nurja, djali i shtëpisë ishte një ndër veprimtarët dhe propagandistët e shquar të LANÇ-it. Aliu iu lut që ta merrte partizan dhe Nurja pranoi. Nuk kaloi shumë kohë dhe Tenda e Qypit u ndez dhe qielli mori flakë, jo një ditë, por katër ditë e tre netë. Dolëm të gjithë dhe shikonim përtej. Bëhëj luftë e ashpër. Luftonin djemtë e nënave kundër gjermanit. Mbas katër ditësh lufta pushoi. Dola dhe prisja ndonjë lajm. Kur shoh të vijë Nurja me disa shokë. Shkova me vrap dhe e përqafova, ndërsa ai më pushtoi fort dhe nuk më lëshonte. E pyeta për Aliun, por ai heshti.

- Më thuaj, është vrrarë Aliu?

Atij i ranë lotët dhe unë e kuptova. M'u duk sikur një rufe më përshkoi trupin, pastaj e mblodha veten dhe i thashë:

- Ma sillni ta varrosim si i ka hije. Ai ra për Shqipëri, të më rroni ju, bijtë e nënës...

Atë betejë, populli i Skraparit deri në Myzeqe, e përjetësoi me vargjet:

*N'ato male mbi Spatharë*

*Luftojnë ca partizanë*

*Grupi tretë, Brigadë e Parë*

*Mehmeti me Zylyftarë*

*Një plumb i mallkuar*

*Ç'e plagosi Zylyftarë*

*Lazen dhëmballë më dhëmballë*

*Aliu i vogël, mbeti i vrrarë...*

Eshtrat e tij prehen në varrezat e dëshmorëve të Skraparit.

Në këtë 65 vjetor të rënies, Aliun e kujtojmë të gjithë të afërmit e tij bashkë me luftëtarët dhe i gjithë populli i Skraparit.

NGA DEMIR KORITA

Rahman Qazim Petova lindi në një familje atdhetare, më 1923, në fshatin Petovë të Fierit. Babai i tij Qazimi, më 1920, mori pjesë në luftën e Vlorës kundër fashistëve italianë, ndërsa gjyshi i tij ishte delegat në Kongresin e Lushnjës. I lindur dhe i edukuar me virtytet më të mira patriotike në këtë familje atdhetare, Rahmani u lidh familjarisht me lëvizjen antifashiste. Shtëpia e tij, që në fillim u bë bazë për patriotët dhe partizanët e asaj krahe. Ajo vuri në dispozicion të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, pa kursim, gjithë potencialin e saj material e shpirtëror, duke u bërë kështu një shembull i veçantë në këtë zonë partizane të Myzeqesë. I vëllai i Rahmanit, Shyqyriu dhe kushëriri, Haliti, pjesëtar i batalionit partizan të Myzeqesë, bien heroikisht në luftë kundër armikut. Vendin e tyre në rreshtat partizane, me pushkën krahut, e zuri djaloshi 15 vjeçar, trimi dhe patrioti i kësaj familjeje Rahman Qazim Petova.

Rahmani në fillim u inkuadrua në grupin partizan të Myzeqesë dhe më pas në Brigadën e XVI Sulmuese, ku merr pjesë në shumë luftime, brenda territorit shqiptar, e deri në Vishegrad të Jugosllavisë dhe vazhdimisht dallohet për vendosmëri, guxim dhe trimëri.

Më 24 maj 1944, në Kongresin historik të Përmetit, Rahmani partizan, besnik dhe i vendosur për idealet komuniste u caktua të bënte roje në sallën kryesore, ku zhvilloheshin punimet. Me shumë nostalgji, ai tregon se "pas përfundimit me sukses të tij, m'u dha mundësia të takohesha për herë të parë me Komandantin e Përgjithshëm dhe birin e shtrenjtë të popullit tonë, shokun Enver Hoxha, takim që mbetet më i bukuri i jetës sime. E kam takuar disa herë pas çlirimit, në Shijak, kur erdhi për ndërtimin e qytetit dhe të urës së shkatërruar nga lufta. U takuam dhe u përqafoam si vëllezër e bashkëluftëtarë të një ideali, por takimi i parë do të mbetet i paharruar". Rahmani është plagosur tri herë në luftimet e ashpra me armikun dhe aktualisht është invalid dhe veteran i Klasis të Parë, i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Vitet e para të çlirimit u inkuadrua në Brigadën e Forcave të Mbrojtjes së Popullit. Veprimtaria e kësaj brigade shtrihet kryesisht në verilindje të vendit tonë, në Shkodër, Kukës, Tropojë dhe zonën e thellë malore të lballës në rrethin e Pukës. Ato vite në ndjekje të diversantëve e armiqtë të arratisur nga vendi ynë, të ardhur nga jashtë, nga vendet e Perëndimit, të cilët pjesërisht u asgjësuan dhe u kapën të gjallë. Rahman Petova shquhej në luftime dhe përsëri u plagos rëndë. Ishte kujdesi i veçantë i Partisë dhe personalisht i shokut Enver që ai të shpëtonte nga vdekja. Për ta lehtësuar nga detyrat e vështira ushtarake, Partia e dërgoi për të punuar në terren në rrethin e Fierit, me detyra shtetërore dhe të partisë, të cilat i kreu me ndershmëri dhe përkushtim në të dy epopetë, atë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe të pasçlirimit. Në luftë dhe në punë ai shpalosi vlerat e larta si njeri fisnik, që kurdoherë karakterizohej nga vendosmëria dhe guximi në të gjitha situatat.

Një kohë të gjatë, deri sa doli në pension, punoi në Ndërmarrjen "8 Nëntori" në Sukth. Atë e gjeje përherë pranë njerëzve, duke biseduar për hallet dhe problemet që i preokuponin. Natyrisht, kjo lidhje me njerëzit ishte meritë, cilësi e veçantë e këtij burri që e ka skalitur me fisnikëri ndërgjegjen e tij.

Populli i Sukthit, ku ai punoi dhe jeton prej shumë vitesh, e vlerësojnë xha Rrahmanin për ndihmën e madhe që u ka dhënë atyre në shumë drejtime, duke shprehur mirënjohje, konsiderata e mendime nga më të përzemërtat. Si njohës i thellë i zakoneve të popullit tonë në ruajtjen dhe mbrojtjen e pronës së përbashkët, ka ditur të kombijë, me



arsye të plotë traditën me kërkesën ligjore e shoqërore të kohës. Dhe kjo mënyrë zgjidhjeje e kombinimi i këtyre anëve, e vinin atë në pozita përparuese e krijuese në zbatimin e drejtë të ligjeve e rregullave për të cilat ishte ngarkuar. Pra, ai gjithnjë e ka vënë veten në pozitat e atij hallexhiut dhe mbi atë bazë i ka dhënë zgjidhje problemeve të ndryshme që i kanë dalë gjatë jetës. Është dalluar gjithnjë për zbatimin e ligjeve dhe të rregullave të Partisë dhe të shtetit.

Për 100 vjetorin e lindjes së shokut Enver Hoxha, ishte në Gjirokastër së bashku me shokë dhe shoqe nga Sukthi, ku përshëndeti këtë eveniment të madh në emër të veteranëve të Shqipërisë. Me punën e tij të palodhur ka ngritur këto ditë edhe një organizatë partie prej 14 anëtarësh. Ai vazhdon të kryejë aktivitetin e tij edhe në organizata të tjera shoqërore, edhe pse është në moshën 80 vjeçare, zbaton me përpikmëri detyrat që i ngarkohen.

Rahmani është një prind shembullor, ka rritur dhe ka edukuar 15 fëmijë, 10 djem dhe 5 vajza të mrekullueshëm si edhe nipër e mbesa, të cilët e respektojnë dhe e duan shumë babanë dhe gjyshin e tyre, që iu përkushtua me aq mund dhe, i përgatiti për jetën.

Për merita në luftë dhe në punë është dekoruar 7 herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë, ndërsa Këshilli Bashkiak i qytetit të Sukthit, për meritat e tij si pjesëmarrës në Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, kontributin si veteran dhe invalid i kësaj lufte, për veprimtarinë shoqërore si qytetar në dobi të komunitetit, i dha titullin e lartë "Qytetar nderi i qytetit të Sukthit", ndërkohë që, po nga ky Këshill Bashkiak u vendos që një nga rrugët e qytetit të Sukthit të mbajë emrin "Ruga Rahman Petova". Të dyja këto vendime tregojnë edhe njëherë se, një njeri me vlera nderohet dhe respektohet deri në përjetësi.

Për shokun Rrahman Qazim Petova duhet të shkruhet shumë, sepse aq i madh është edhe kontributi i tij në shërbim të popullit shqiptar, por unë po e përfundoj këtë shkrim modest me një urim të thjeshtë: "Shëndet të plotë, qofsh përherë i gëzuar dhe paçi vetëm mirësi në familjen tuaj të madhe dhe të nderuar!"

NGA MUHO ASLLANI  
Sekretar Politik i PPSHR

# BOTA në kthetrat e krizës financiare

Kriza është një problem serioz dhe shqetësues që qëndron në rend të ditës pothuajse në të gjitha vendet e botës. Alarmin më të madh e ka dhënë qeveria e SHBA e cila, kohët e fundit ka ndërhyrë me 850 miliard dollarë për të ndihmuar sadopak zbutjen e krizës së thellë financiare që ka mbërthyer e tronditur të gjitha qeveritë e botës. Të gjithë janë të preokupuar për këtë rënie ekonomike të perandorisë më të madhe të kohës e cila, sikur të dalë jashtë kontrollit mund të shkaktojë një krizë të thellë e të papëmbajtur si ajo e vitit 1930, me pasoja katastrofike globale. Nga kjo është një preokupacion i ligjshëm e shumë serioz për të ardhmen ekonomike amerikane, që është lideri i ekonomisë botërore. Specialistë të ekonomisë bëjnë analiza e përlogaritje dhe parashikime mbi pasojat që do të ketë kjo krizë mbi ekonominë e vendit të tyre dhe diskutojnë për masat që duhen marrë në politikën e përgjithshme ekonomike globale për ta penguar dhe evituar rritjen dhe përhapjen e saj me shpejtësi.

Nga të dhënat e deritanishme, situata në SHBA



nuk është shumë premtuese. Në këto momente deficitit i llogarive rrjedhëse ka arritur shifrën 195 miliard dollarë që është sasia më e madhe në gjithë historinë e këtij vendi. SHBA aktualisht kanë një borxh të jashtëm shumë të madh dhe janë të detyruar të emëtojnë së fundi një sasi prej 1.3 bilion dollarë bono thesari për shtetet e tjera, shumë kjo që në total ka arritur shifrën prej 2.5 bilionë dollarë. Kjo gjendje e rëndë

ekonomike ka ardhur, sipas specialistëve amerikanë, sepse janë harxhuar nga qeveria e Bushit duke shkëlur principet tradicionale fiskale të ekonomisë, pra janë harxhuar më shumë para se sa është prodhuar, duke përfshirë edhe fitimet ose tepricat, prej 115 miliard dollarësh, të grumbulluara nga administrata e Klintonit. Aktualisht vendi ka një humbje ose deficit të përgjithshëm prej 247 miliardë dollarësh. Tjetër dukuri negative është rënia e vazhdueshme e vlerës së dollarit në sasi dhe kredibilitet (besueshmëri) sepse nuk ka mbështetje të fuqishme në flori apo në monedha të tjera të materialeve ekuivalente, për shkak të borxhit të madh të jashtëm shtetëror. Mund të themi pa frikë se në nivele rekord, si asnjë herë tjetër, deviza amerikane ka humbur deri tani thuajse gjysmën e vlerës së saj, duke agravuar e kërcënuar seriozisht krizën e tregut të bursës dhe

vlerën e pasurive të shërbimeve. Sado që kjo krizë financiare nuk ka një impakt të madh e direkt deri tani në Evropë, ajo nuk duhet nënvleftësuar e anashkaluar. Është e vërtetë se dollari i zhvleftësuar e favorizon Evropën për blerjen e naftës por, në të njëjtën kohë, kjo bën që prodhimet evropiane të shtrenjtohen çdo ditë e më tepër, duke e vënë në disbalancë raportin midis avantazheve dhe disavantazheve ekonomike.

Kriza financiare që po troket sot në botë do ta thellojë akoma më shumë varfërinë për masat punonjëse e cila, edhe kështu siç është, të trondit thellë. Ndërsa në botë sot shpenzohen 1000 miliard dollarë për armë, më se 850 milionë njerëz vuajnë nga uria, 1 miliard njerëz nuk kanë ujë të pijshëm, 2.6 miliardë njerëz nuk kanë shërbime shëndetësore, 800 milionë vetë janë analfabetë, më se 650 milionë fëmijë nuk kanë kushte jetese të përshtatshme, 115

milionë fëmijë nuk shkojnë në shkollë fillore ndërsa 10 milionë vdesin para se të mbushin 5 vjeç nga sëmundje që mund të kurohen. Vendet e Amerikës së Jugut vuajnë çdo herë e më shumë nga fatkeqësitë e natyrës, pasojat e së cilës janë agravuar për shkak të ndryshimit të klimës. Rritja e çmimit të naftës është rezultat i konsumit irracional, i aktivitetit spekulativ dhe i aventurave ushtarake të superfuqive. Kërkesa e dëshpëruar për burime të reja të energjisë ka nxitur strategjinë kriminale për t'i shndërruar bereqetet në burim energjie në vend të naftës, duke mos u merakosur fare për kafshatën e gojës të miliona njerëzve të varfër në botë.

Kjo situatë shpërthyesë kërkon një rend të ri ekonomik-shoqëror, nën udhëheqjen e forcave të vërteta revolucionare antiimperialiste, që të interesohet për zhvillimin dhe forcimin e paqes, të solidaritetit midis kombeve, të drejtësisë shoqërore dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike për të gjithë sot në botë. Këto janë rrugët që sigurojnë të ardhmen. Nuk ka alternativa të tjera për të shpëtuar nga kriza që kërcënon botën.

NGA: SHEZAI SHYTI

## Medvedevi drejton - Putini qeveris!...



**Rusi:** Më në fund, Dimitri Medvedev mori drejtimin e vendit, më 7 maj 2008. Ai fitoi në zgjedhje që nuk qenë modeli i demokracisë dhe me një shtyp e televizion të kontrolluar nga shteti. Këshilli i Evropës nuk deshi të verifikonte çregullimet e vërejtura. Me cinizëm apo me realizëm një gazetar theksoi se rusët nuk janë të mësuar të zgjedhin, porse të mbështesin kandidatin e zgjedhur nga padrinia (Putini). Megjithatë, duhet theksuar se për herë të parë në gjithë historinë ruse një udhëheqës rus e lë pushtetin vullnetarisht, në një moment që gëzonte popullaritet të madh.

Medvedev lindi në San Petersburg (Leningrad), para 42 vjetësh. I ati ishte profesor i shquar universiteti, ndërsa nëna mësuese. Në kushte të tilla pati një edukim të

privilegjuar dhe me komoditet në Rusinë Sovjetike. Studioi dhe mbaroi Universitetin në San Petersburg për avokat dhe shumë shpejt filloi të punojë me Putinin në vitet 1990, por në ndryshim nga ai nuk punoi asnjëherë në KGB.

Medvedev thotë se është avokat "deri në kockë", i saktë dhe i rregullt, që pretendon të krijojë një Rusi "të shtetit të së drejtës", ku ligjet të respektohen dhe t'i jepet fund korrupsionit në të gjitha nivelet, ndryshe nga premtimi i Putinit për "diktaturë të ligjit". Ai përsërit sentencën se "liria është më e mirë nga mungesa e saj" dhe flet për mundësinë e internetit si mjet informimi në vend. Paraqitet me një imazh liberal, por s'është i dobët, premtion të reformojë pavarësinë e drejtësisë, të eliminojë arbitraritetet, të mbrojë pronën private

dhe të luftojë korrupsionin. Ka shumë miq pronarë të "Rusisë së re" që janë të interesuar të shtrihen në Evropë. Tani nuk gëzon simpatinë e ish-ushtarakëve dhe funksionarëve të sigurimit si Putini.

Pas fasadës së avokatit të ri, nuk duhet harruar fakti që ai ka qenë për 17 vjet bashkëpunëtor i Putinit, që është një produkt perfekt i KGB-së, tani FSB. Dhe bashkëpunoi gjatë me padrinon e tij në rimëkëmbjen e ndërmarrjeve të privatizuara nga Jelcin, në kontrollin e mjeteve të komunikimit dhe në përdorimin e shitjeve të energjisë si mjet presioni diplomatik. Medvedev deklaroi që në fillim se Putini do të ishte kryeministër dhe do vendoste me të një bashkëqeverisje, diçka që i shqetëson e i intrigon anëtarët e G8, të cilët pyesin: Kush do ta drejtojë delegacionin e Rusisë në mbledhjen e ardhshme të nivelit të lartë, në korrik, në Japoni? Medvedev sqaron se Kushtetuta përcakton qartë se cili duhet të drejtojë politikën e jashtme të vendit, por Putini lë të nënkuptohet, me veprimet e tij, se do të vazhdojë të jetë ai njeriu i fortë dhe, si provë e saj, është fakti që do ta ruajë vijën presidenciale në Moskë dhe Daçën (vilën) në Soshi, në jug të Rusisë.

Për faktin se ka qenë 8 vjet në pushtet, ai kontrollon shumicën në parlament (Duma), shërbimet sekrete (FSB), Forcat e Armatosura dhe ndërmarrjet e mëdha që përbëjnë bazën ekonomike ruse. Në këto rrethana, duket e vështirë që Medvedev të mund të adoptojë një rrugë shumë të pavarur.

Në fushën ekonomike shpreson që ekonomia ruse të vazhdojë të rritet sipas rritjes së çmimit të gazit, të naftës dhe të mineraleve në përgjithësi.

## "Sahara nuk shitet..."

Populli saharian në 60 vjetorin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut

Duke folur e trajtuar gjendjen e rëndë ekonomike dhe politike të Saharasë Perëndimore, si rezultat i shtypjes dhe shfrytëzimit të regjimit barbar Aluid në fuqi dhe i ndërhyrjes së fuqive të mëdha si Franca, Spanja etj, për interesat e tyre gjeostrategjike, në artikull theksohet se "lufta e armatosur e filluar nga organizata POLISARIO më 1975 u ndërpre në

1991, sepse iu premtua që në rrugë paqësore dhe diplomatike të ndërmjetësuar nga OKB, mund të garantohej referendum i dëshiruar i vetëvendosjes. Franca, Spanja dhe vende të tjera të "civilizuara", flasin me të madhe kundër forcës e violencës, por me qëndrimet e tyre të dyshimta të deritanishme po e çojnë prapa popullin saharian drejt rrëmbimit të armëve për të mbrojtur të drejtat e veta legjitime.

Megjithëse deri tani janë bërë shumë bisedime, ato kanë ngecur në vend. Fronti POLISARIO ka deklaruar hapur dhe prerazi se në qoftëse nuk zgjidhet konflikti me bisedime do detyrohen të marrin prapë armët. Shumica dërrmuese e saharianëve mendojnë se "ata nuk do të tërhiqen nëse nuk ka sukses zgjidhja diplomatike e konfliktit, prandaj janë të vendosur se alternativa e fundit është të rrëmbejnë prapë armët. Ky është mendimi i vendosur i shumicës së



saharianëve, të cilët i bëjnë presion të vazhdueshëm organizatës së Frontit POLISARIO. Situata ndërkombëtare e krizës së përgjithëshme ekonomike duket se aktualisht nuk do të sjellë asgjë të mirë për zgjidhjen me negociata të konfliktit të ngrirë. Por vullneti i vendosur i popullit saharian për të mbrojtur të drejtat dhe tokën e vet është një garanci e fortë dhe e sigurtë e perspektivës revolucionare. Në këtë rrugë ata nuk do të jenë vetëm, ashtu siç nuk kanë qenë edhe në të kaluarën. Populli spanjoll dhe gjithë popujt e botës do i mbështesin ashtu siç kanë bërë deri tani revolucionarët saharianë, në rrugën e tyre drejt lirisë dhe pavarësisë. Po tingëllohen e fortë jehona e zërit të tyre se "Sahara nuk shitet, ndërsa për t'u dorëzuar as që flitet fare".

Faqja u përgatit nga: SHEZAI SHYTI